


## **Projekti: “Ndërtimi i kapaciteteve drejt zhvillimit të qëndrueshëm të kapitalit në Maqedoninë e Veriut”**

### **Fusha e Aktivitetit II - Zhvillimi dhe realizimi i Aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve për ndryshimet klimatike dhe shëndetin**

#### **Plani i Veprimit për Dekarbonizimin e Sektorit të Shëndetësisë**



© Ed Hawkins, Qendra Nacionale për Shkencën Atmosferike, UoR.

Autorë: Jasminka Dimitrova Kapac, Elizabet Kampel

## Tabela e Përmbajtjes

<b>Akronimet</b> .....	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<b>Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	<b>6</b>
<b>1 Objektivi dhe përfshirja e Planit të Veprimit</b> .....	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
1.1 Propozimi i intervenimeve specifike për të reduktimin e emetimeve të GS-ve dhe rreziqeve klimatike.....	10
1.2 Të udhëzohen profesionistët e sektorit shëndetësor për adresimin e rreziqeve shëndetësore në lidhje me klimën përmes bashkëpunimit.....	12
1.3 Qasjet shëndetësore me karbon të ulët për forcimin e funksioneve të sistemit shëndetësor dhe për qëndrueshmërinë ndaj klimës.....	13
1.4 Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi për vendimmarrësit shëndetësorë për rezistencën klimatike dhe dekarbonizimin. ....	14
<b>2 Punë përgatitore</b> .....	<b>15</b>
<b>3 Përmbledhje për ndryshimet klimatike dhe ndikimet mbi shëndetin</b> .....	<b>18</b>
3.1.1 Sëmundjet dhe vdekjet që ndërlidhen me nxehtësinë.....	18
3.1.2 Rritja e incidencës së sëmundjeve të transmetuara nga vektorët .....	19
3.1.3 Sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare .....	20
3.1.4 Sëmundjet që ndërlidhen me ujin .....	21
3.1.5 Siguria ushqimore dhe ushqyerja .....	22
3.1.6 Shëndeti mendor dhe mirëqenia.....	22
3.1.7 Zhvendosja dhe migrimi .....	22
3.1.8 Popullatat e lëndueshme .....	23
<b>4 Përshkrimi i Qasjes në zbatimin e Planit të veprimit</b> .....	<b>23</b>
4.1 Përcaktimi i fushave kryesore që do të synohen me Planin e Veprimit. ....	23
4.2 Metodologjitë dhe kornizat që do të përdoren për zbatimin e Planit të Veprimit, qasja nga poshtë-lart.....	24
4.3 Si integrohet plani i veprimit me politikat dhe kornizat ekzistuese.....	25
<b>5 Angazhimi i palëve të interesuara</b> .....	<b>27</b>
5.1 Identifikimi i aktorëve kryesorë dhe roleve të tyre. ....	27

5.2	Strategjia për angazhimin e palëve të interesit gjatë fazave të planifikimit dhe zbatimit.....	28
<b>6</b>	<b>Qeverisja dhe Korniza Institucionale.....</b>	<b>30</b>
6.1	Strukturat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit.....	30
6.2	Rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe institucioneve të ndryshme.....	31
<b>7</b>	<b>Fushat e Veprimit dhe Strategjitë.....</b>	<b>33</b>
7.1	Përshkrimi i detajuar i veprimeve specifike që duhen ndërmarrë në sektorët thelbësorë.....	33
7.2	Infrastruktura dhe objektet shëndetësore .....	33
7.2.1	Qeverisja .....	33
7.2.2	Përmirësimet e Efikasitetit Energjetik.....	35
7.2.3	Integrimi i Energjisë së Rinovueshme.....	36
7.2.4	Dizajne rezistente ndaj klimës.....	37
7.2.5	Ruajtja e Ujit.....	38
7.2.6	Transport i qëndrueshëm.....	39
7.2.7	Reduktimi dhe trajtimi i hedhurinave .....	40
7.2.8	Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm (EWS).....	42
7.2.9	Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor .....	43
7.2.10	Përkrahja për popullatat e lëndueshme .....	43
7.2.11	Prokurimet e gjelbra në Sektorin e Shëndetësisë .....	44
7.2.12	Ushqyerja dhe Ushqimi .....	44
7.2.13	Kimikatet.....	45
<b>8</b>	<b>Treguesit e Performancës dhe Monitorimi.....</b>	<b>47</b>
8.1	Treguesit kryesorë të performancës për matjen e progresit drejt objektivave të planit të veprimit. ....	47
8.2	Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit.....	48
<b>9</b>	<b>Resurset Financiare dhe Mobilizimi.....</b>	<b>49</b>
9.1	Përmbledhje e kërkesave buxhetore.....	50
9.2	Strategjitë për mobilizimin e resurseve financiare duke përfshirë burimet potenciale të financimit.....	51
<b>10</b>	<b>Menaxhimi i Rrezikut dhe Zbutja.....</b>	<b>52</b>



10.1	Identifikimi i reziqeve potenciale dhe strategjitë e zbutjes së tyre. ....	52
10.2	Plane për menaxhim me kriza për t'i adresuar sfidat e paparashikuara.....	54
11	<i>Referencat:</i> .....	56

## Akronimet

CO <sub>2</sub> e	Ekivalenti i CO <sub>2</sub>
E	Emetimi
EE	efikasiteti energjetik
EF	Faktori i Emetimit
GHG	gaz serë
GHGs	gazrat serë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
GWP	Potenciali i ngrohjes globale
IPCC	Paneli Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut
MSH	Ministria e Shëndetësisë
PNP	Plani Nacional i Përshtatjes
KNNK	Këshilli Nacional për Ndryshimet Klimatike
NDA	Autoriteti Nacional i Përcaktuar
NDC	Kontributi i Përcaktuar Nacional
BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
RNM	Republika e Maqedonisë së Veriut
SDG-të	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

## Përmbledhje Ekzekutive

Plani i veprimit synon të mbështesë dekarbonizimin e sektorit shëndetësor në Maqedoninë e Veriut me reduktimin e emetimeve të gazrave serë nga operacionet e objekteve të kujdesit shëndetësor dhe duke rritur qëndrueshmërinë ndaj klimës. Në të janë përshkruar strategjitë kryesore për t'i arritur këto qëllime, duke përfshirë përmirësimet e efikasitetit energjetik, integrimin e energjisë së rinovueshme, transportin e qëndrueshëm dhe të gjelbër si dhe përmirësimet e menaxhimit të hedhurinave.

Plani i veprimit përcakton masa specifike për reduktimin e emetimeve të gazeve serë nga sektori shëndetësor, duke kontribuar në objektivat e përgjithshme nacionale të Maqedonisë së Veriut, siç është përcaktuar në NDC-në e saj<sup>1</sup>. NDC-ja i përkufizon objektivat dhe strategjitë e vendit për reduktimin e emetimeve të gazrave serë, duke përfshirë angazhimin për një reduktim prej 51% deri në vitin 2030 dhe reduktim prej 72% deri në vitin 2050 krahasuar me nivelet e vitit 1990. Në sektorin e mbrojtjes shëndetësore, reduktimi i emetimeve të GS-ve do të arrihet kryesisht duke zbatuar masa për efikasitet energjetik, përmes integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe duke promovuar praktika të qëndrueshme në objektet e kujdesit shëndetësor.

*Është shumë e rekomandueshme që Ministria e Shëndetësisë të angazhohet formalisht për arritjen e neutralitetit klimatik në sektorin e shëndetësisë deri në vitin 2050 dhe të vendos objektiva të përkohshme (p.sh. 2030, 2040). Gjithashtu, rekomandohet shumë të bëhen vlerësime vjetore ose dyvjeçare të progresit.*

NDC-ja aktuale e Maqedonisë së Veriut është e fokusuar kryesisht në zbutjen, megjithatë, dokumenti përmend synimin për të inkorporuar një komponent përshtatjeje në parashtratat e ardhshme. Qeveria po punon në mënyrë aktive në zhvillimin e Planit të saj të parë Nacional të Përshtatjes (PNP). Ky plan do t'i adresojë sfidat e shfaqura nga ndryshimet klimatike në ekosistemet, bujqësinë dhe burimet ujore, si dhe do të përfshijë strategji për integrimin e perspektivave për ndryshimet klimatike në politikat nacionale dhe proceset e planifikimit. Komponenti i përshtatjes do të hartohet për të rritur kapacitetin e palëve të interesuara nacionale, për të siguruar përdorimin e veglave me ndjeshmëri gjinore dhe për të rritur ndërgjegjësimin dhe përkrahjen e publikut në lidhje me përpjekjet për përshtatjen klimatike.

Plani i veprimit u zhvillua duke u bazuar në njohuritë e fituara gjatë dy aktiviteteve të para të projektit dhe në takimet me palët e interesuara. Plani i veprimit përfshin 13 fusha të politikave:

- Qeverisja

<sup>1</sup>Burimi: <https://unfccc.int/documents/497726>



- Përmirësimet e Efikasitetit Energjetik
- Integrimi i Energjisë së Rinovueshme
- Dizajn i qëndrueshëm ndaj klimës
- Ruajtja e Ujit
- Transport i qëndrueshëm
- Reduktimi i hedhurinave dhe trajtimi i hedhurinave
- Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm
- Promovimi dhe Edukimi për Shëndetin
- Mbështetja e popullsisë në nevojë
- Ushqyerja dhe Ushqimi
- Kimikatet

Megjithëse qëllimi parësor i planit të veprimit është të mbështesë zhvillimin e nivelit të ulët të karbonit, janë përfshirë edhe veprime për përshtatje, meqë këto kishin rëndësi shumë të madhe për palët e interesuara.

Plani i veprimit përfshin masa për përmirësimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor, që të jetë më e rezistente ndaj ngjarjeve ekstreme të motit dhe ndikimeve të tjera klimatike. Kjo përfshin punime ndërtimore shtesë në objektet, përmirësimin e izolimit dhe instalimin e sistemeve të sofistikuar për ngrohje, ventilim dhe klimatizim (HVAC) që janë njëkohësisht me efikasitet energjetik dhe qëndrueshmëri ndaj kushteve të ndryshueshme klimatike.

Forcimi i gatishmërisë emergjente dhe aftësive të reagimit në sektorin e shëndetësisë është një komponent qenësor. Kjo përfshin zhvillimin dhe zbatimin e planeve për menaxhimin e emergjencave shëndetësore që janë në lidhje me ndryshimet klimatike, siç janë valët e të nxehtit, vërshimet dhe epidemitë e sëmundjeve të ndjeshme ndaj klimës.

Menaxhimi efikas i resurseve ujore dhe hedhurinave nga mbrojtja shëndetësore është thelbësor për qëndrueshmërinë ndaj klimës. Plani promovon përdorimin e teknologjive dhe praktikave të kursimit të ujit, si dhe sisteme të qëndrueshme të menaxhimit të hedhurinave me çka reduktohet ndikimi mjedisor dhe zmadhohet qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit.

Plani i veprimit e mbështet integrimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, si pompat e nxehtësisë diellore dhe gjeotermale, në objektet e kujdesit shëndetësor. Ky tranzicion jo vetëm që e redukton gjurmën e karbonit nga ky sektor, por gjithashtu siguron një furnizim të besueshëm dhe të qëndrueshëm me energji.

Zbatimi i masave për efikasitet energjetik nëpër objektet e kujdesit shëndetësor do të jetë prioritet. Kjo përfshin përmirësimin e sistemeve të ndriçimit, ngrohjes dhe ftohjes, si dhe përmirësimin e

izolimit të ndërtesave dhe miratimin e sistemeve inteligjente të menaxhimit të energjisë për të optimizuar përdorimin e energjisë.

Plani inkurajon miratimin e opsioneve të transportit me karbon të ulët për operacionet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë mjete motorike elektrike për transport mjekësor dhe inkurajimin e personelit për të përdorur metoda të qëndrueshme të udhëtimit. Përveç kësaj, ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse për transport inteligjent me karbon të ulët në objektet e kujdesit shëndetësor është një pjesë integrale e angazhimeve për reduktimin e gjurmës së karbonit.

Plani i veprimit është krijuar për t'u integruar pa probleme me politikat dhe kornizat ekzistuese nacionale, siç është Plani Nacional për Energji dhe Ndryshimet Klimatike<sup>2</sup>, Strategjia Nationale e Zhvillimit<sup>3</sup>, Plani i Transformimit të Sistemit Shëndetësor<sup>4</sup>, Shëndeti Mjedisor Maqedonia e Veriut Profili i vendit 2023<sup>5</sup>, etj. Kjo siguron një qasje kohezive për arritjen e objektivave nacionale për klimë dhe e rrit efektivitetin e përgjithshëm të planit.

Ligji për Efikasitet Energjetik parasheh reduktimin e kërkesës për energji nëpërmjet përdorimit efikas të energjisë duke zbatuar masa për kursimin e energjisë. Plani i veprimit kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë duke reduktuar konsumin e energjisë përmes masave të efikasitetit dhe minimizimin e ndikimit negativ mbi mjedisin jetësor. Kjo e mbështet drejtpërdrejt objektivin ligjor për zvogëlimin e kërkesës për energji dhe ndikimit mbi mjedisin jetësor. Ndërtesat që janë në pronësi dhe i përdor sektori publik, edhe në nivel qendror edhe në nivel lokal, duhet t'i plotësojnë standardet minimale të performancës energjetike të përcaktuara me ligj. Plani i veprimit e mbështet këtë duke përfshirë dispozita për inspektim energjetik dhe rinovim me qëllim që të garantohet që këto standarde do të përmbushen. Gjithashtu, plani i veprimit korrespondon me kërkesën që 3% e ndërtesave shtetërore të modernizohen në nivel vjetor, me inspektime energjetike të kryera nga organizata të licencuara që angazhojnë auditorë të certifikuar për energjetikë.

Zbatimi efektiv i planit të veprimit kërkon bashkëpunim me një spektër të gjerë palësh të interesuara, duke përfshirë ministritë e qeverisë, institucionet në nivel qendror dhe lokal, shërbimet e kujdesit shëndetësor, organizatat e shoqërisë qytetare dhe sektorin privat. Plani i përshkruan strategjitë për angazhimin e këtyre palëve të interesuara dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre aktive në procesin e planifikimit dhe zbatimit.

<sup>2</sup>Burimi: <https://www.energy-community.org/news/Energy-Community-News/2022/06/01.html>

<sup>3</sup>Burimi: <https://northmacedonia.un.org/en/221034-national-development-strategy>

<sup>4</sup>Burimi: <https://www.who.int/news-room/feature-stories/detail/who-and-partners-highlight-way-forward-to-improve-health-equity-across-north-macedonia>

<sup>5</sup>Burimi: <https://www.who.int/publications-detail/environmental-health-north-macedonia-2023-country-profile>



Plani i Veprimit për Dekarbonizimin e Sektorit të Shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut paraqet një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar për adresimin e sfidave të dyfishta të ndryshimeve klimatike dhe shëndetit publik. Duke u përafuar me angazhimet sipas Marrëveshjes së Parisit dhe NDC-ve të vendit, plani jo vetëm që kontribuon në përpjekjet globale për të luftuar ndryshimet klimatike, por edhe siguron që sektori shëndetësor në Maqedoninë e Veriut të jetë i përgatitur për t'u përballur dhe përshtatur me ndikimet e një klime që ndryshon. Nëpërmjet veprimeve të synuara në reduktimin e emetimeve, rritjen e qëndrueshmërisë, përforcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin e palëve të interesuara, plani synon të krijojë një sistem shëndetësor që është i qëndrueshëm, me karbon të ulët dhe është rezistent ndaj klimës për të ardhmen.

Maqedonia e Veriut përparon drejt zgjerimit të BE-së dhe është palë nënshkruese e Komunitetit për Energji, prandaj kërkohet që të përafrohet me politikat e BE-së për klimën dhe energjinë, siç është zbatimi i rregullores së BE-së për qeverisje. Deklarata e Sofjes e cila e përfshin Agjendën e Gjelbër, e cila është në përputhshmëri me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së, është nënshkruar në vitin 2020.

Maqedonia e Veriut duhet ta harmonizojë legjislacionin e saj nacional me direktivat e BE-së për veprimin klimatik dhe shëndetin publik. Kjo përfshin miratimin dhe zbatimin e rregulloreve të BE-së për emetimet e gazrave serë, cilësinë e ajrit dhe qëndrueshmërinë e sektorit shëndetësor.

Me rëndësi thelbësore është rritja e kapaciteteve të institucioneve shtetërore për menaxhimin dhe zbatimin efektiv të politikave klimatike dhe shëndetësore. Kjo nënkupton përmirësimin e sistemeve për mbledhjen e të dhënave, monitorim dhe raportim me qëllim të përmbushjes së kërkesave të BE-së.

Investimi në infrastrukturë të qëndrueshme shëndetësore që mund t'u bëjë ballë ndikimeve klimatike është me rëndësi thelbësore. Kjo donë të thotë përmirësim i objekteve të kujdesit shëndetësor që të jenë me efikasitet energjetik dhe të afta për të funksionuar në kushte ekstreme të motit.

Me përmbushjen e këtyre angazhimeve, Maqedonia e Veriut mund të përparojë në procesin e saj për zgjerimin e BE-së duke siguruar që sektori shëndetësor i shtetit është në një rrugë zhvillimi me karbon të ulët dhe i aftë për të mbrojtur shëndetin publik përballë ndryshimeve klimatike.

Kapitulli i parë i Planit të Veprimit për Klimën i përshkruan qëllimin dhe përfshirjen, duke i përfshirë edhe objektivat kryesore që duhen përmbushur. Kapitulli i dytë i përshkruan aktivitetet e punës që janë ndërmarrë në përpilimin e këtij plani të veprimit, i cili përfshin vlerësimin e emetimeve të GS-ve në sektorin e shëndetësisë. Kapitulli i tretë shtjellon rreziqet klimatike që i kanosen sektorit

të shëndetësisë. Në kapitullin e katërt, fokusi është në qasjen e zbatimit, ndërsa kapitulli i pestë fokusohet mbi palët e interesuara që do të jenë të përfshira. Në vazhdim është përshkruar mekanizmi i qeverisjes, i cili duhet të krijohet për të siguruar zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm (Kapitulli 6). Një përshkrim i veprimeve që do të zbatohen në 13 fusha politikash është përfshirë në Kapitullin 7, i shoqëruar nga një grup treguesish kryesorë të performancës për të monitoruar progresin (Kapitulli 8). Kapitujt e fundit i adresojnë resurset financiare të nevojshme dhe mobilizimin e tyre (Kapitulli 9) dhe në fund, një përshkrim i masave për zbutjen e rrezikut gjatë zbatimit.

## 1 Objektivit dhe përfshirja e Planit të Veprimit

Synimi kryesor i këtij plani të veprimit është që të mbështetet një zhvillim me shkallë të ulët të karbonit në sektorin e shëndetësisë. Ky plan është krijuar në bazë të analizës së kryer institucionale, vlerësimit të emetimeve të GS-ve në sektorin e shëndetësisë dhe konsultimeve të zhvilluara me palë të përfshira në sektorin e shëndetësisë dhe në sferën klimatike. Planit i veprimit synon:

- Të propozojë intervenime specifike për t'i reduktuar emetimet e GS-ve dhe rreziqet klimatike.
- T'i udhëzojë profesionistët e sektorit shëndetësor në adresimin e rreziqeve shëndetësore që janë në lidhje me klimën nëpërmjet bashkëpunimit.
- T'i forcojë funksionet e sistemit shëndetësor për qëndrueshmëri klimatike si dhe qasjet shëndetësore me karbon të ulët.
- T'i përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë për vendimmarrësit shëndetësorë në qëndrueshmërinë klimatike.

Elaborimi i detajuar i objektivave është paraqitur në këtë seksion të Planit të veprimit.

### 1.1 Propozimi i intervenimeve specifike për reduktimin e emetimeve të GS-ve dhe rreziqeve klimatike

Trajtimi i ndryshimeve klimatike në sektorin e kujdesit shëndetësor është thelbësor si për qëndrueshmërinë mjedisore ashtu edhe për qëndrueshmërinë e shëndetit publik. Objektet e kujdesit shëndetësor janë konsumatorë të rëndësishëm të energjisë dhe të resurseve, duke kontribuar në emetimet e gazrave serë. Zbatimi i strategjive për zbutjen e ndikimeve klimatike në

kujdesin shëndetësor jo vetëm që e redukton gjurmën e karbonit të sektorit, por gjithashtu rrit rezistencën e shërbimeve të mbrojtjes shëndetësore ndaj atyre ndikimeve. Maqedonia e Veriut, si shumë vende, përballet me sfidën e dyfishtë të përmirësimit të shërbimeve për mbrojtje shëndetësore duke reduktuar ndikimet mjedisore. Me përvetësimin e praktikave të efikasitetit energjetik, me kalimin në energjinë e rinovueshme, me promovimin mënyrave të transportit të qëndrueshëm dhe zbatimin e dizajnit të qëndrueshëm si dhe menaxhimit të hedhurinave, objektet e kujdesit shëndetësor mund të luajnë një rol qenësor në përpjekjet shtetërore dhe globale klimatike. Intervenimet e propozuara përfshijnë:

- Zbatimin e praktikave të efikasitetit energjetik në objektet e kujdesit shëndetësor, siç janë zëvendësimi i ndriçimit me LED, optimizimi i sistemeve për ngrohje, ventilim dhe klimatizim (HVAC) dhe përdorimi i pajisjeve mjekësore me efikasitet energjetik.
- Kalimi në burimet e rinovueshme të energjisë si energjia nga drita diellore, nga era ose energjia gjeotermale për furnizimin me energji të objekteve të kujdesit shëndetësor.
- Inkorporim i parimeve të projektimit të qëndrueshëm në ndërtimin dhe rinovimin e objekteve të kujdesit shëndetësor, siç është përdorimi i materialeve ekologjike ndërtimore dhe zbatimi i teknologjive për kursim të ujit.
- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për reduktimin e hedhurinave që përfshijnë riciklimin, kompostimin dhe asgjësimin e duhur të hedhurinave të rrezikshme medicinale.
- Miratimi i politikave të qëndrueshme të prokurimit që i japin përparësi blerjes së produkteve ekologjike dhe me efikasitet energjetik.
- Inkurajimi i përdorimit të automjeteve me emetim të ulët për transport dhe zbatimi i praktikave të telemjekësisë për të reduktuar nevojën për udhëtime të pacientëve dhe personelit.
- Mbështetje dhe financim i kërkimeve për teknologjitë dhe praktikatat inovative që reduktojnë emetimet e gazrave serë në sektorin e kujdesit shëndetësor.
- Zbatim i programeve-pilot për të testuar strategji të reja zbutëse dhe për rritjen e iniciativave të suksesshme.
- Krijimi i sistemeve për monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të intervenimeve për reduktimin e rreziqeve klimatike dhe emetimeve, duke përdorur tregues sikur konsumi i energjisë, nivelet e emetimeve dhe rezultatet shëndetësore.
- Angazhim për politikave nacionale dhe lokale që i përkrahin përpjekjet për zbutjen e klimës, sikur normat për emetimet, stimujt për energjinë e rinovueshme dhe mbështetje për praktikatat e qëndrueshme të kujdesit shëndetësor.
- Shfrytëzim i të dhënave nga monitorimi me qëllim që në mënyrë të vazhdueshme të përmirësohen intervenimet dhe për t'u siguruar që ato të jenë efektive dhe të adaptueshme ndaj kushteve që ndryshojnë.



- Të shfrytëzohet sektori i shëndetësisë si një shumëfishues për ndërgjegjësimin lidhur me ndryshimet klimatike duke përfshirë një numër të madh të njerëzve me prejardhje të ndryshme.

## 1.2 Të udhëzohen profesionistët e sektorit shëndetësor për adresimin e rreziqeve shëndetësore që janë në lidhje me klimën nëpërmjet bashkëpunimit

Objektivi kryesor është të ofrojë udhëzime të qarta për profesionistët e sektorit shëndetësor se si t'i trajtojnë rreziqet shëndetësore në lidhje me klimën. Ky objektivi thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm për t'i zbutur dhe përshtatur në mënyrë efektive ndikimet që ndryshimet klimatike i kanë mbi shëndetin. Arritjet që bëjnë pjesë në këtë objektivi përfshijnë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me nevojën për të vepruar për zbutjen e emetimeve të GS-ve dhe për të rritur shkallën e pranimin për zbatimin e masave për zbutjen e ndikimeve klimatike.
- Identifikim i ndikimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndryshimeve klimatike mbi shëndetin, siç janë rritjet në përhapjen e sëmundjeve që ndërlidhen me nxehtësinë, sëmundjet e transmetuara nga vektorët, problemet respiratore dhe çështjet e shëndetit mendor.
- Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të rrezikut për t'i identifikuar popullatat e cenueshme dhe rajonet më të prekura nga ndryshimet klimatike.
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve shëndetësorë, institucioneve mjedisore, autoriteteve qeveritare, organizatave joqeveritare (OJQ) dhe komunitetit për të zhvilluar strategji të integruara.
- Inkurajimi i partneriteteve ndërmjet sektorit të shëndetit publik dhe subjekteve private për t'i shfrytëzuar resurset dhe ekspertizën.
- Të sigurohen trajnime dhe edukime të vazhdueshme për profesionistët e shëndetësisë lidhur me ndryshimet klimatike dhe shëndetin, duke u siguruar që ata të kenë njohuritë dhe aftësitë për trajtimin e kërcënimeve shëndetësore që shfaqen.
- Të sigurohet alokimi i resurseve adekuate për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë resurset financiare, teknologjike dhe njerëzore.
- Përfaqësim i politikave që mbështesin rezistencën e sektorit të shëndetësisë ndaj kushteve klimatike, duke përfshirë financimin për kërkime, përmirësime të infrastrukturës dhe iniciativa të shëndetit publik.

- Inicim i fushatave lidhur me ngritjen e vetëdijes për rreziqet shëndetësore që ndërlidhen me ndryshimet klimatike dhe për të promovuar përfshirjen e komunitetit në përpjekjet për përshtatje dhe zbutje.
- Zbatimi i aktiviteteve të bazuara në komunitet që adresojnë rreziqe dhe dobësi të veçanta lokale shëndetësore.
- Krijimi i sistemeve për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rezultateve shëndetësore në lidhje me ndryshimet klimatike. Shfrytëzim i të dhënave për të informuar vendimmarrjen dhe për të përmirësuar strategjitë për intervenime.
- Zhvillim i mekanizmave të raportimit për të përcjell progresin dhe për të ndarë praktikat dhe mësimet më të mira që janë nxjerr nga profesionistët shëndetësorë dhe palët e interesuara.
- Raportim i rregullt për rezultatet dhe progresin tek palët e interesuara, duke përfshirë autoritetet qeveritare, institucionet e mbrojtjes shëndetësore dhe publikun.

### 1.3 Qasjet shëndetësore me karbon të ulët për forcimin e funksioneve të sistemit shëndetësor dhe për qëndrueshmërinë ndaj kushteve klimatike

Objektivi synon të rrit rezistencën e sistemeve shëndetësore ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike duke promovuar qasjet shëndetësore me karbon të ulët. Kjo përfshin përshtatjen e sistemeve shëndetësore për t'u bërë ballë dhe për t'iu përgjigjur streseve në lidhje me klimën si dhe kalimin në praktika të qëndrueshme që e minimizojnë gjurmën e karbonit të operacioneve të kujdesit shëndetësor.


Forcimi i funksioneve të sistemit shëndetësor për rezistencë ndaj kushteve klimatike dhe qasjet shëndetësore me karbon të ulët kërkojnë një angazhim të qartë dhe mekanizma të përshtatshëm qeverisës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin. Kjo përfshin një qasje të shumëanshme, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve, qëndrueshmërinë e infrastrukturës, praktikat e qëndrueshme, ndërtimin e kapaciteteve, zhvillimin e politikave, kërkimin dhe monitorimin e vazhdueshëm. Plani i veprimit në fjalë, paraqet bazën për zhvillimin e një sektori shëndetësor me gjurmë të vogël karboni dhe rezistencë ndaj kushteve klimatike në Maqedoninë e Veriut.

## 1.4 Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi për vendimmarrësit shëndetësorë për rezistencën klimatike dhe dekarbonizimin

Zbatimi i ndërhyrjeve në lidhje me klimën kërkon rregullime institucionale, procedurale dhe legjislative të ristrukturuara mirë, me përcaktim të roleve dhe përgjegjësi. Vendimmarrja është njëra pjesë e tij, por zbatimi i veprimeve kërkon përkrahje në të gjithë sektorin e shëndetësisë. Prandaj, një mekanizëm i qartë qeverisës është thelbësor për të arritur ndryshime dhe përmirësime reale në dobi të njerëzve dhe mjedisit.

Ministri i Shëndetësisë dhe funksionarët e lartë të shëndetësisë janë përgjegjës për dhënien e udhëzimeve strategjike dhe angazhimin publik për dekarbonizimin e sektorit shëndetësor deri në vitin 2050 dhe integrimin e këtyre synimeve në Kontributin e Përcaktuar Nacional si dhe koordinimin nëpërmjet Komitetit Nacional për Ndryshimet Klimatike. Do të arrihen rezultatet e mëposhtme:

- Krijimi i një pike qendrore në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) ose Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), mundësisht në Departamentin për Analitikë, Planifikim dhe Projekte.
- Sigurohet që pika e kontaktit të ketë përkrahje nga personeli përkatës dhe të ketë rregullime procedurale për bashkëpunim.






Figura 1 Pika fokale e propozuar në Ministrinë e Shëndetësisë

- Zhvillimi i një platforme digjitale për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për emetimet dhe konsumin e energjisë, si dhe të dhëna të tjera në lidhje me klimën, të rëndësishme për vendimmarrësit në sektorin e shëndetësisë.
- Lehtësimi i kontakteve të drejtpërdrejta me ministrinë e tjera për integrimin horizontal.
- Mbështetja e institucioneve shëndetësore në përpjekjet për dekarbonizimin dhe promovimi i bashkëpunimit ndërsektorial përmes grupeve të punës dhe takimeve të rregullta.
- Sigurimi i financimit për projektet e zbatueshme dhe iniciativat për ngritjen e kapaciteteve.
- Angazhim për alokim të zmadhuar të resurseve dhe kërkim të opsioneve të ndryshme për financim, duke përfshirë bonot e gjelbra dhe fondet ndërkombëtare klimatike.
- Angazhim me institucionet e financimit dhe konsultime me qendrat shëndetësore për mundësitë e financimit.

## 2 Punë përgatitore

Si hap i parë në hartimin e këtij plani të veprimit, kemi zbatuar një rishikim dhe analizë të plotë të boshllëqeve institucionale dhe organizative në Sektorin e Shëndetësisë, me fokus mbi Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) dhe Institutin për Shëndet Publik (ISHP). Kjo analizë ka përfshirë rekomandime specifike për krijimin e një pike apo ekipi të dedikuar për ndryshimet klimatike në sektorin e shëndetësisë. Qëllimi ishte rritja e koordinimit, planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të

masave për ndryshimet klimatike. Kjo përpjekje synon të sigurojë që sektori i shëndetësisë është mirë i përgatitur që në mënyrë efektive t'i adresojë ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Hapi i dytë ishte vlerësimi i emetimeve të GS-ve nga sektori i shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut. Me të, merren parasysh Protokollin për Kontabilitet Korporativ dhe Standarde të Raportimit për GHG, duke mbajtur llogari për emetimet e drejtpërdrejta në institucionet dhe emetimet e tërthorta nga energjia elektrike dhe termike e blerë. Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet pyetësorëve, kontakteve personale dhe hulumtimeve mbi dokumentet që ishin në dispozicion për prokurimet publike. Faktorët e emetimit dhe të konvertimit janë të dokumentuara dhe mundësojnë një përditësim të inventarit të emetimeve në vitet e ardhshme. Janë konsultuar gjithsej 93 institucione të sektorit të shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut, nga kujdesi shëndetësor sekondar dhe terciar.

Për vlerësimin e emetimeve të gazrave serë në sektorin e shëndetësisë së Maqedonisë së Veriut, janë marrë parasysh fusha 1 (emetimet e drejtpërdrejta) dhe fusha 2 (emetimet e tërthorta nga energjia elektrike dhe termike e blerë). Nga fusha 3, në të cilën bëjnë pjesë shkarkimet e tërthorta që rezultojnë nga prodhimi i materialit klinik ose emetimet nga trajtimi i hedhurinave nuk janë marrë parasysh, për shkak të të dhënave jo të plota që i kanë mbledhur institucionet.

Të dhënat e paraqitura më poshtë janë mbledhur për përllogaritjen e emetimeve të GS-ve nga sektori i shëndetësisë:


- Konsumi i energjisë elektrike në rrjet
- Energji termike e blerë
- Konsumi i karburantëve për prodhim të energjisë elektrike në vend:
- Konsumi i lëndëve djegëse për ngrohje: vaj ekstra i lehtë (naftë), mazut, dru
- Përdorimi i benzinës, dizelit, GLN për transport
- Përdorimi i GS-ve relevante
  - Ftohës të rimbushur
  - Gazrat anesteziqë
  - Gazrat analitike.

Bazuar në të dhënat e aktiviteteve të mbledhura nga institucionet shëndetësore të Maqedonisë së Veriut dhe faktorët e emetimit që janë përdorur (kryesisht nga IPCC-ja), **emetimet totale rezultojnë në 88 kt CO<sub>2</sub>e në vitin 2022.**

Sasitë totale më të fundit të emetimeve të GS-ve në nivel nacional janë publikuar si pjesë e Komunikimit të 4-të Nacional. Këtu është raportuar që emetimet totale të GHG-ve në nivel nacional arrijnë në 11 267 kt CO<sub>2</sub>e (me përjashtim të pylltarisë dhe përdorimit të tokës) për vitin 2019. Edhe pse viti referencë nuk është i njëjtë, janë pranuar edhe të dhënat nga viti 2019 për



një vlerësim të përafërt. **Përqindja e sektorit të shëndetësisë arrin deri 0.8% të totalit të emetimeve të GS-ve në nivel nacional (duke përfshirë FOLU).**



*Përqindja e burimeve të emetimit të GHG-ve*

2% 1% 1% 0%

**Energjia**  
**Transporti**  
**Ftohës të rimbushur**  
**Gazrat anesteziqë**  
**Gazrat analitike**

96%

Figura 2 Pjesa e burimeve të emetimit të GS-ve në sektorin e shëndetësisë

### 3 Përmbledhje për ndryshimet klimatike dhe ndikimet mbi shëndetin

Ndryshimet klimatike gjithnjë e më shumë po afirmohen si një nga kërcënimet më të mëdha shëndetësore globale të shekullit 21. Ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi shëndetin janë të shumëllojshme dhe të shumëfishta, duke ndikuar edhe mbi përcaktuesit fizikë edhe ata socialë të shëndetit. Në Maqedoninë e Veriut, rritja e temperaturave, valët më të shpeshta të të nxehtit dhe ndryshimi i modeleve të reshjeve tashmë po ndikojnë mbi shëndetin publik. Këto ndryshime mjedisore sjellin rreziqe të konsiderueshme shëndetësore, si sëmundjet e lidhura me nxehtësinë, sëmundjet e transmetuara nga vektorët dhe gjendjet e përkeqësuar respiratore nga ndotja e ajrit. Të kuptuarit e lidhjes midis ndryshimeve klimatike dhe shëndetit është me rëndësi thelbësore për zhvillimin e strategjive efektive të përshtatjes dhe zbutjes në sektorin e shëndetësisë.

#### 3.1.1 Sëmundjet dhe vdekjet që ndërlidhen me nxehtësinë

**Valët e të nxehtit:** Frekuenca, intensiteti dhe kohëzgjatja e valëve të të nxehtit po rritet për shkak të ndryshimeve klimatike. Këto situata ekstreme të nxehtësisë mund të shkaktojnë rraskapitje nga nxehtësia, sulm nga nxehti dhe përkeqësim të gjendjeve ekzistuese shëndetësore sikur sëmundjet kardiovaskulare dhe me frymëmarrjen. Popullatat e lëndueshme, duke përfshirë të moshuarit, fëmijët dhe ata me probleme kronike shëndetësore, janë në një rrezik më të lartë.

**'Ishujt' Urban të Nxehtësisë:** Zonat urbane shpesh përjetojnë temperatura më të larta se sa zonat rurale për shkak të efektit të ishullit të nxehtësisë, i cili mund t'i intensifikojë ndikimet shëndetësore të valëve të nxehtit. Ky fenomen paraqet rreziqe shtesë për popullatat urbane, veçanërisht për ato që jetojnë në banesa me popullsi të dendur dhe me ajrosje të dobët.

Ndryshimet klimatike kanë shkaktuar ndikim të konsiderueshëm në Maqedoninë e Veriut, duke çuar në rritje të frekuencës, intensitetit dhe kohëzgjatjes së valëve të nxehtit. Këto ngjarje ekstreme të nxehtësisë paraqesin rreziqe serioze për shëndetin dhe çojnë në përkeqësimin e problemeve ekzistuese shëndetësore.

Maqedonia e Veriut ka përjetuar një rritje të theksuar të temperaturave mesatare gjatë viteve të fundit. Për shembull, gjatë verës së vitit 2021 janë regjistruar disa nga temperaturat më të larta gjatë dekadave të fundit, të cilat gjatë disa ditëve kanë arritur edhe mbi 40°C. Ngjashëm, gjatë verës së vitit 2023 ka pasur periudha të zgjatura të nxehtësisë ekstreme, që rezultoi me paralajmërime për shëndetin publik dhe masa për të mbrojtur grupet e brishta të popullatës.

Gjatë vitit 2024, Maqedonia e Veriut më shumë herë gjatë stinës së verës ka përjetuar temperatura më të larta se 40°C, me maksimumin që ishte 42°C. Kjo valë e zgjatur e të nxehtit është pjesë e një tendence më të gjerë që prek Evropën Jugore dhe Ballkanin.

Numri i ditëve të valëve të nxehtit është dyfishuar në dy dekadat e fundit. Sipas Drejtorisë për Punë Hidrometeorologjike të Maqedonisë, frekuenca e valëve të nxehtit është rritur për rreth 20% gjatë 30 viteve të fundit<sup>6</sup>.

Gjatë valëve të nxehtit, shënohet rritje e konsiderueshme e rasteve të hospitalizimit të personave me probleme shëndetësore që ndërlidhen me nxehtësinë, siç janë rraskapitje nga nxehtësia, sulm nga i nxehti dhe dehidrimi. Popullatat e lëndueshme, duke përfshirë të moshuarit, fëmijët dhe individët me probleme kronike shëndetësore, janë veçanërisht të rrezikuar.

Temperaturat e larta përkeqësojnë sëmundjet kardiovaskulare dhe respiratore, duke çuar në rritje të vizitave në repartin e urgjencave dhe hospitalizimit të pacientëve.

### 3.1.2 Rritja e incidencës së sëmundjeve të transmetuara nga vektorët

**Ndryshimet në habitatet:** Vendi po përjeton ndryshime në modelet klimatike që mund të ndikojnë në përhapjen e sëmundjeve të transmetuara nga vektorët. Ndryshimet klimatike shkaktojnë ndryshime në habitatet dhe ciklet jetësore të vektorëve siç janë mushkonjat, rriqrat dhe mizat, duke çuar në përhapjen e sëmundjeve si malaria, ethet e dengës, virusi Zika, sëmundja Lyme dhe ethet 'çikungunja' në rajone të reja. Temperaturat më të ngrohta dhe rritja e reshjeve krijojnë kushte të favorshme që këta vektorë të shumohen dhe të zgjerojnë përfshirjen e tyre.

Malaria dhe Ethet e dengës: Temperaturat më të ngrohta dhe reshjet e shtuara krijojnë kushte të përshtatshme për shumimin e mushkonjave. Edhe pse malaria u çrrënjës në Maqedoninë e Veriut, klima në ndryshim mund të krijojë kushte për shumimin e sërishëm ose sëmundje të reja të shkaktuara nga mushkonjat siç janë ethet e dengës. Virusit Zika dhe ethet 'çikungunja': Këto viruse, të transmetuara nga mushkonjat edes, mund të kalojnë në përmasa shqetësuese nëse mushkonjat e zgjerojnë prezencën e tyre në Maqedoninë e Veriut. Sëmundja Lyme: Temperaturat më të ngrohta dhe ndryshimi i ekosistemeve mund të çojnë në një rritje të popullsisë së rriqrave. Mund të ndodh që Maqedonia e Veriut të vërejë rritje në rastet e sëmundjeve të transmetuara nga rriqrat siç është sëmundja Lyme, e cila tashmë është e pranishme në Evropë dhe Maqedoninë e Veriut.

<sup>6</sup>Burimi: <http://www.meteo.gov.mk/>

**Sfidat e shëndetit publik:** Përhapja e shtuar e sëmundjeve të transmetuara nga vektorët paraqet sfidë të madhe për shëndetin publik, veçanërisht në zonat ku këto sëmundje më parë ishin të pazakonta, duke çuar në mungesë të imunitetit dhe të gatishmërisë të popullata.

### 3.1.3 Sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare

**Cilësia e ajrit:** Ndryshimi i klimës ndërvepron me cilësinë e ajrit nëpërmjet rritjes së niveleve të ndotësve si ozoni, grimcat (PM) dhe alergjenët. Këta ndotës mund t'i përkeqësojnë gjendjet respiratore siç janë astma dhe sëmundjet pulmonare obstruktive kronike (SPOK), si dhe sëmundjet kardiovaskulare.<sup>7</sup>

Grimcat (PM10 dhe PM2.5):

Nivelet e grimcave PM10: Shkupi dhe të gjitha qytetet e tjera më të mëdha, shpesh përjetojnë nivele të grimcave PM10 që i tejkalojnë vlerat që janë të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh). Nivelet mesatare ditore të grimcave PM10 shpesh tejkalojnë limitin e BE-së prej 50 µg/m<sup>3</sup>, veçanërisht gjatë muajve të dimrit për shkak të rritjes së ngrohjes dhe aktiviteteve industriale.

Nivelet e grimcave PM2.5: grimcat PM2.5, të cilat mund të depërtojnë thellë në mushkëri dhe të futen në qarkullimin e gjakut, mbetet gjithashtu një shqetësim i madh. Nivelet e grimcave PM2.5 shpesh i tejkalojnë vlerat që konsiderohen të sigurta, duke kontribuar për probleme serioze shëndetësore.

Ozoni (O3): Ndotja e ozonit paraqet problem gjatë muajve të verës kur temperaturat më të larta lehtësojnë reaksionet kimike që formojnë ozonin në nivelin e tokës. Ky ndotës është veçanërisht i dëmshëm për njerëzit me sëmundje të frymëmarrjes.

Alergjenët: Ndryshimi i klimës e zgjat sezonin e polenit dhe rrit përqendrimin e alergjenëve në ajrin, duke përkeqësuar gjendjet si astma dhe riniti alergjik.

Cilësia e dobët e ajrit përkeqëson astmën, duke çuar në shtimin e hospitalizimeve dhe vizitave në repartin e urgjencës, veçanërisht gjatë episodeve me ndotje të lartë.<sup>8</sup> Pacientët me SPOK vuajnë nga acarime më të shpeshta dhe të rënda gjatë periudhave të ndotjes së lartë me grimca. Ekspozimi ndaj niveleve të larta të grimcave ndërlidhet me rrezikun e shtuar të sulmeve në zemër, sulmeve në tru dhe sëmundjeve të tjera kardiovaskulare.

<sup>7</sup>Burimi: <https://www.who.int/data/gho/data/themes/air-pollution>

<sup>8</sup>Të dhënat për cilësinë e ajrit në kohë reale mund t'i gjeni në platformat sikur AirVisual, linku: <https://www.iqair.com>

**Zjarret pyjore:** Zjarret gjithnjë e më shumë janë bërë një çështje e rëndësishme në Maqedoninë e Veriut dhe diçka që është përkeqësuar nga ndryshimet klimatike. Rritja e temperaturave dhe periudhat e zgjatura të thatësisë kanë çuar në zjarre më të shpeshta dhe të mëdha, duke ndikuar edhe mbi mjedisin jetësor edhe mbi shëndetin publik.

Të dhënat paraqesin një trend të rritjes së numrit dhe intensitetit të zjarreve në Maqedoninë e Veriut. Në shtet, çdo vit ndodhin raste të shumta zjarresh, veçanërisht gjatë muajve të nxehtë dhe të thatë të verës. Për shembull, në vitin 2021, vendi u përball me një sezon të rëndë zjarresh, me qindra zjarre të raportuara në rajone të ndryshme. Në vitin 2021, Maqedonia e Veriut regjistroi mbi 300 raste zjarresh, me zjarret më të mëdha në rajonet e Kumanovës, Staro Nagoriçanit dhe Koçanit. Këto zjarre kanë bërë të evakuhohen disa fshatra dhe kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme mbi pronat dhe infrastrukturën. Sipas Agjencisë Informative të Maqedonisë (MIA), në sezonin e zjarreve të vitit 2021 janë regjistruar disa nga temperaturat më të larta dhe aktiviteti më i madh i zjarreve në dekadat e fundit.<sup>9</sup>

Që nga mesi i korrikut të vitit 2024, rreth 15 zjarre të mëdha janë raportuar në pjesë të ndryshme të vendit, me 10 prej këtyre zjarreve si raste të zjarreve aktive. Zonat kryesore të prekura përfshijnë Kumanovën dhe malin Serta, ku zjarret kanë shkaktuar dëme të mëdha.

Maqedonia e Veriut kërkoi ndihmë nga Bashkimi Evropian për t'u bërë ballë këtyre zjarreve. Si përgjigje, u aktivizua Mekanizmi për Mbrojtje Civile i BE-së, duke çuar në aktivizimin e avionëve dhe helikopterëve zjarrfikës nga vende të ndryshme, duke përfshirë nga Serbia, Sllovenia, Turqia dhe Kroacia.<sup>10</sup>

Zjarret pyjore kanë pasur ndikim të rëndë mbi cilësinë e ajrit, duke rritur nivelet e grimcave dhe ndotësve të tjerë, të cilët përkeqësojnë gjendjet respiratore dhe kardiovaskulare. Autoritetet kanë ndaluar lëvizjen nëpër pyje gjatë orëve të caktuara për të parandaluar incidente të mëtejshme dhe për të garantuar sigurinë publike.

### 3.1.4 Sëmundjet që ndërlidhen me ujin

**Mungesa e ujit:** Ndryshimet në modelet e reshjeve dhe rritja e shkallës së avullimit për shkak të temperaturave më të larta mund të çojnë në mungesë uji. Kjo mungesë ndikon në cilësinë dhe

<sup>9</sup>Burimi: <https://mia.mk/>

<sup>10</sup>Burimi: <https://www.ekathimerini.com/news/environment/1245206/north-macedonia-is-seeking-eu-assistance-as-wildfires-burn-across-the-balkans/>

sasite e ujit në dispozicion, duke e zmadhuar rrezikun nga sëmundjet e shkaktuara nga uji, sikur kolera, dizenteria dhe sëmundje të tjera diarreike.

**Vërshimet:** Rritja e shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve të dendura dhe vërshimeve mund ta kontaminojë infrastrukturën e furnizimit me ujë me patogjenë dhe ndotës, duke çuar në epidemi të sëmundjeve të shkaktuara nga uji. Vërshimet gjithashtu mund t'i prishin sistemet sanitare, duke e përkeqësuar në mënyrë plotësuere situatën me përhapjen e sëmundjeve.

### 3.1.5 Siguria uhqimore dhe ushqyerja

**Ndikimet bujqësore:** Me ndryshimet e temperaturave, reshjeve dhe shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme të motit, ndryshimet klimatike ndikojnë në produktivitetin bujqësor. Këto ndryshime mund të çojnë në dështime të të korrave, rendimente të reduktuara dhe mungesë ushqimi, duke ndikuar mbi sigurinë e ushqimit dhe të ushqyerit.

**Cilësia ushqyese:** Rritja e niveleve të CO<sub>2</sub> mund të zvogëlojë cilësinë ushqyese të kulturave kryesore, si gruri dhe orizi, duke ulur përmbajtjen të proteinave, zinkut dhe hekurit në to. Kjo mund të përkeqësojë gjendjen me kequshqyerjen, veçanërisht te popullatat e cenueshme.

### 3.1.6 Shëndeti mendor dhe mirëqenia

**Stresi psikologjik:** Ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, humbjen e mjeteve ekzistenciale dhe zhvendosjen, mund të çojnë në rritje të stresit psikologjik, ankthit, depresionit dhe problemeve të tjera për shëndetin mendor.

**Përçarja e komunitetit:** Zhvendosja dhe migrimi për shkak të ndryshimeve klimatike mund të prishin komunitetet, duke çuar në izolim social dhe humbje të rrjeteve të mbështetjes sociale, të cilat janë qenësore për shëndetin mendor dhe mirëqenien.

### 3.1.7 Zhvendosja dhe migrimi

**Refugjatët e klimës:** Ngjarjet ekstreme të motit dhe degradimi i mjedisit mund t'i detyrojnë komunitetet të zhvendosen, duke krijuar refugjatë klimatikë. Zhvendosja mund të çojë në mbipopullim në zonat urbane, me çka shkaktohet mbingarkesë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe infrastrukturës.

**Mbingarkimi i shërbimeve shëndetësore:** Migrimi dhe zhvendosja për shkak të ndryshimeve klimatike mund t'i mbingarkojnë të punësuarit aktual shëndetësorë në qendrat për këto shërbime,

duke çuar në rritje të kërkesës për kujdes shëndetësor dhe rritje të sfidave në dhënien e kujdesit adekuat për të gjitha popullatat e prekura.

### 3.1.8 Popullatat e lëndueshme

Disa popullata janë më të cenueshme ndaj ndikimeve shëndetësore të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë:

**Të moshuarit:** Personat në moshë më të thellë janë më të ndjeshëm ndaj sëmundjeve që ndërliken me nxehtësinë, problemet me frymëmarrjen dhe ndikimet shëndetësore nga ngjarjet ekstreme të motit.

**Fëmijët:** Fëmijët janë veçanërisht të cenueshëm ndaj ndikimeve të cilësisë së dobët të ajrit, sëmundjeve të shkaktuara nga uji dhe mangësive ushqyese.

**Komunitetet me të ardhura të ulëta:** Këto komunitete shpesh kanë qasje të kufizuar në kujdesin shëndetësor, jetojnë në zona që janë më të brishta ndaj rreziqeve mjedisore dhe nuk kanë burime për t'u adaptuar ndaj ndryshimeve klimatike.

**Personat me probleme ekzistuese shëndetësore:** Individët me sëmundje kronike sikur astma, diabeti dhe sëmundjet e zemrës janë në rrezik më të lartë që të kenë pasoja të pafavorshme shëndetësore si rezultat i ndryshimeve klimatike.

## 4 Përshkrimi i Qasjes në zbatimin e Planit të Veprimit

### 4.1 Përcaktimi i fushave kryesore që do të synohen me planin e veprimit

Plani i Veprimit fokusohet mbi fushat e mëposhtme në sektorin e shëndetësisë:

- Qeverisja
- Përmirësimet e Efikasitetit Energjetik
- Integrimi i Energjisë së Rinovueshme
- Dizajn i qëndrueshëm ndaj klimës
- Ruajtja e Ujit
- Transport i qëndrueshëm
- Reduktimi i hedhurinave dhe trajtimi i hedhurinave
- Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm

- Promovimi i Shëndetit dhe Edukimi
- Mbështetje e popullatës së cenushme
- Ushqyerja dhe Ushqimi
- Kimikatet

#### 4.2 Metodologjitë dhe kornizat që do të përdoren për zbatimin e Planit të Veprimit, qasja nga poshtë-lart

Zbatimi i Planit të Veprimit për Dekarbonizimin e Sektorit të Shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut kërkon një qasje holistike dhe gjithëpërfshirëse për të siguruar suksesin dhe qëndrueshmërinë e tij. Një qasje nga poshtë-lart është veçanërisht e rëndësishme në këtë kontekst pasi i përfshin palët e interesuara lokale në proceset e vendimmarrjes, në këtë mënyrë duke nxitur pronësi dhe duke siguruar që strategjitë të jenë të përshtatura për nevojat dhe kushtet specifike lokale. Kjo qasje jo vetëm që rrit rëndësinë dhe efektivitetin e intervenimeve, por gjithashtu i fuqizon komunitetet dhe institucionet shëndetësore lokale për të marrë pjesë aktive në veprimet klimatike.

##### Metodologjitë:

1. **Vlerësimi i rrezikut dhe prioritizimi:** Zhvillimi i vlerësimeve gjithëpërfshirëse të rrezikut për identifikimin dhe prioritizimin e rreziqeve më kritike klimatike për sektorin e shëndetësisë.
2. **Angazhimi i palëve të interesuara:** Përfshirja e të gjitha palëve të interesuara në procesin e planifikimit dhe zbatimit përmes konsultimeve, seminarëve dhe platformave për bashkëpunim.
3. **Ngritja e kapaciteteve:** Të ofrohen trajnime dhe resurse për profesionistët dhe institucionet shëndetësore për të ndërtuar kapacitetet e tyre me qëllim që të përgjigjen ndaj rreziqeve klimatike dhe për t'ir zbatuar masat zbutëse.

##### Kornizat:

1. **Korniza e Sistemeve Shëndetësore Rezistente ndaj Klimës (OBSH):** Përshtatja e kornizës së OBSH-së për të rritur qëndrueshmërinë e sistemeve shëndetësore ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.
2. **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG):** Përafrimi i planit të veprimit me SDG-të përkatëse, veçanërisht Objektivin 3 (Shëndet i mirë dhe Mirëqenia) dhe Objektivin 13 (Veprimi Klimatik).
3. **ISO 14001 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor:** Zbatimi i standardit ISO 14001 për të krijuar një sistem efektiv të menaxhimit mjedisor në objektet e kujdesit shëndetësor.



### Qasja nga poshtë-lart:

1. Inkurajimi i institucioneve lokale shëndetësore për të zhvilluar dhe zbatuar planet e tyre të veprimit klimatik bazuar në rreziqet dhe burimet lokale.
2. Angazhimi i punonjësve shëndetësorë nga komuniteti dhe organizatat lokale në fushata për ngritjen e vetëdijes dhe aktivitete për rritjen e rezistencës.

### 4.3 Si integrohet Plani i Veprimit me politikat dhe kornizat ekzistuese

#### Integrimi me politikat ekzistuese:

**Plani Nacional për Energjinë dhe Ndryshimet Klimatike (NECP)<sup>11</sup>:** Plani i Veprimit për Dekarbonizimin e Sektorit të Shëndetësisë duhet të jetë në lidhje të ngushtë me Planin Nacional për Energjinë dhe Klimën (NECP) të Maqedonisë së Veriut, i cili përshkruan strategjinë e përgjithshme të vendit për reduktimin e emetimeve të gazrave serë dhe rritjen e rezistencës ndaj klimës. NECP paraqet një kornizë për integrimin e veprimit klimatik nëpër sektorë të ndryshëm, duke përfshirë kujdesin shëndetësor.

#### Subjektet përgjegjëse:

Ministria e Shëndetësisë: Udhëheq me zbatimin e intervenimeve specifike për sektorin shëndetësor.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor: Koordinon veprimin e përgjithshëm klimatik dhe sigurimin e harmonizimit me NECP.

Këshilli Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm: Lehtëson angazhimin e palëve të interesuara dhe mbikëqyrjen e integritetit të politikave klimatike në të gjithë sektorët.

**Zhvillimi i vazhdueshëm i Planit Nacional të Përshtatjes (PNP) në kuadër të projektit GCF UNDP:** Për të siguruar që masat e përshtatjes klimatike specifike për sektorin shëndetësor të përfshihen në NDC për adresimin e dobësive dhe rreziqeve të posaçme me të cilat përballen shërbimet e kujdesit shëndetësor.

**Kontributet e përcaktuara në nivel nacional (NDC):** Duke përfshirë angazhimet e sektorit të kujdesit shëndetësor për reduktimin e emetimeve dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë në NDC-të e vendit sipas Marrëveshjes së Parisit.

<sup>11</sup>Burimi: [https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/national-energy-climate-plans\\_en](https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/national-energy-climate-plans_en)

**Kornizat e Vetëqeverisjes Lokale:** Bashkëpunimi me vetëqeverisjet lokale për zbatimin e planeve të veprimit klimatik në nivel rajonal dhe komunal, duke siguruar përaftrim me politikat lokale klimatike dhe planet zhvillimore.

**Strategjia Nacionale e Zhvillimit:** Në Strategjinë Nacionale e Zhvillimit të Maqedonisë së Veriut (SNZH) është përkufizuar një vizion gjithëpërfshirës për zhvillim të qëndrueshëm, duke theksuar rritjen ekonomike, qëndrueshmërinë mjedisore dhe inkluzionin social. Plani i Veprimit për Dekarbonizimin e Sektorit të Shëndetësisë integrohet me këtë strategji duke kontribuar në fusha të shumta thelbësore, duke siguruar që iniciativat e sektorit shëndetësor të korrespondojnë me objektivat më të gjera nacionale.

Rritja e qëndrueshme ekonomike:

**Efikasiteti Energjetik dhe Energjia e Rinovueshme:** Duke zbatuar praktika të efikasitetit energjetik dhe duke kaluar në burime të rinovueshme të energjisë, sektori i shëndetësisë i redukton shpenzimet operative dhe shfrytëzimin e lëndëve djegëse fosile. Kjo është në përputhje me fokusin e NDC-ve për promovimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike nëpërmjet përdorimit efikas të resurseve dhe përvetësimit të teknologjive të gjelbra.

Qëndrueshmëria mjedisore:

**Reduktimi i emetimeve të gazrave serë:** Përpjekjet për dekarbonizimin në sektorin e shëndetësisë kontribuojnë në synimin e përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut për të reduktuar emetimet e gazrave serë. Kjo e mbështet tendencën e NDC-ve për zbutjen e ndikimeve nga ndryshimet klimatike dhe për ruajtjen e burimeve natyrore.

**Menaxhimi i hedhurinave:** Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për reduktimin e hedhurinave në objektet e kujdesit shëndetësor korrespondon me objektivat mjedisore të NDC-ve duke promovuar praktika të qëndrueshme të menaxhimit të hedhurinave dhe duke reduktuar ndotjen e mjedisit.

Inkluzioni Social dhe Shëndeti Publik:

**Rezistenca shëndetësore:** Me ndërtimin e sistemeve shëndetësore rezistente ndaj klimës dhe duke siguruar që shërbimet e kujdesit shëndetësor përgatiten për ndikimet klimatike, plani i veprimit i mbështet objektivat e NDC-ve për përmirësimin e rezultateve të shëndetit publik dhe sigurimin e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore për të gjithë qytetarët.

**Angazhimi i komunitetit:** Angazhimi i komuniteteve lokale në zbatimin e masave të përshtatjes klimatike e avancojnë inkluzionin social dhe i fuqizon popullatat e cënueshme, që paraqet një parim thelbësor i NDC-ve.

Ngritja e Kapaciteteve dhe Inovacioni:

**Trajnime dhe Hulumtime:** Fokusi i planit të veprimit në ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e hulumtimeve mbi teknologjitë inovative është në përputhje me objektivin e NDC-së për nxjften

e arsimit, zhvillimit të aftësive dhe inovacionit teknologjik. Kjo siguron që sektori i shëndetësisë të jetë i pajisur me njohuritë dhe veglat e nevojshme për t'i trajtuar në mënyrë efektive sfidat klimatike.

## 5 Angazhimi i palëve të interesuara

### 5.1 Identifikimi i aktorëve kryesorë dhe roleve të tyre

Identifikimi i palëve të interesuara paraqet një hap vendimtar në zbatimin e suksesshëm të çdo projekti, duke përfshirë Planin e Veprimit për Dekarbonizimin e Sektorit të Shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut. Palët e interesuara janë individë, ekspertë, grupe, punonjës ose përfaqësues qeveritarë, të cilët kanë interes për rezultatin e projektit dhe mund të ndikojnë mbi të ose të kenë ndikim nga zbatimi i tij. Angazhimi i palëve të interesuara siguron që plani të jetë inkluziv, të përfitojë nga ekspertizat e ndryshme dhe të jetë në përputhshmëri me nevojat dhe prioritetet e komunitetit. Në Maqedoninë e Veriut, në fillim të projektit është zhvilluar një analizë institucionale për identifikimin e aktorëve kryesorë dhe roleve të tyre, gjë që është thelbësore për realizimin e koordinuar dhe efektiv të planit të veprimit.

1. **Ministria e Shëndetësisë (MSH):** Siguron udhëheqje të përgjithshme, udhëzim të politikave dhe koordinim për planin e veprimit. Është përgjegjëse për integrimin e rezistencës klimatike në politikat dhe praktikat e sektorit shëndetësor.
2. **Instituti i Shëndetit Publik (ISHP):** Zbaton dhe monitoron rezistencën ndaj klimës dhe programet shëndetësore. Zhvillon hulumtime dhe grumbullimin e të dhënave mbi ndikimet shëndetësore në lidhje me klimën.
3. **Objektet e kujdesit shëndetësor:** Spitalet, klinikat dhe profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor zbatojnë intervenime në terren, përvetësojnë praktika të qëndrueshme dhe raportojnë të dhëna lidhur me emetimet dhe ndikimet klimatike.
4. **Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor:** Bashkëpunon me MSH-në për të siguruar që politikat mjedisore të korrespondojnë me objektivat e sektorit shëndetësor. Siguron ekspertizë për përshtatjen ndaj ndikimeve klimatike dhe zbutjen e tyre.
5. **Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale:** Mbështet kalimin drejt energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit energjetik në sektorin e shëndetësisë. Lehtëson qasjen në resurset dhe stimulimet financiare.
6. **Ministria e Financave:** Shpërndan fonde për projektet e rezistencës ndaj klimës dhe siguron qëndrueshmërinë financiare të iniciativave.

7. **Vetëqeverisjet Lokale:** Zbatojnë dhe realizojnë masat për rezistencën ndaj klimës në nivel rajonal dhe komunal. Angazhohen me komunitetet lokale dhe institucionet shëndetësore.
8. **Organizatat Joqeveritare (OJQ):** Sigurojnë përkrahje teknike, përfaqësim dhe angazhim të komunitetit, lehtësim të fushatave për ngritjen e vetëdijes dhe edukim të publikut.
9. **Organizatat Ndërkombëtare dhe Donatorët:** Ofrojnë financime, asistencë teknike dhe praktikata më të mira. Japin përkrahje për ngritjen e kapaciteteve dhe nismat kërkimore.
10. **Institucionet akademike dhe kërkimore:** Zhvillojnë kërkime lidhur me ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi shëndetin dhe zhvillojnë zgjidhje inovative. Sigurojnë trajnimin dhe edukimin e profesionistëve shëndetësorë.
11. **Sektori Privat:** Investon dhe përvetëson praktika të qëndrueshme. Bashkëpunon për zgjidhje inovative për reduktimin e emetimeve dhe rritjen e rezistencës ndaj klimës.

## 5.2 Strategjia për angazhimin e palëve të interesit gjatë fazave të planifikimit dhe zbatimit

Zbatimi i suksesshëm i strategjive të përshtatjes dhe zbutjes së ndikimeve klimatike në sektorin shëndetësor të Maqedonisë së Veriut mbështetet shumë në angazhimin aktiv të palëve të interesuara. Gjatë vitit të kaluar, projekti ka bërë hapa të mëdhenj në nxitjen e bashkëpunimit dhe mbledhjen e të dhënave përmes seminareve dhe takimeve konsultative. Këto përpjekje kanë siguruar që Plani i Veprimit të jetë gjithëpërfshirës, inkluziv dhe t'i reflektojë perspektivat e ndryshme të të gjitha palëve të përfshira.

Identifikimi dhe angazhimi i palëve të interesuara është me rëndësi thelbësore për të garantuar suksesin dhe qëndrueshmërinë e Planit të Veprimit për Dekarbonizimin e Sektorit Shëndetësor. Palët e interesuara i përfshijnë punonjësit dhe përfaqësuesit qeveritarë, përfaqësuesit nga ISHP-të, OBSH-në, profesionistët e kujdesit shëndetësor, partnerët dhe ekspertët ndërkombëtarë, OJQ-të. Procesi i vazhdueshëm i konsultimeve ka qenë i rëndësishëm në integrimin e komenteve të palëve të interesuara dhe për ndërtimin e një ndjesie të pronësisë dhe përkushtimit në mesin e të gjitha palëve.

Projekti ka organizuar një seminar fillestar për t'i prezantuar objektivat, përfshirjen dhe rezultatet e pritshme të Planit të Veprimit. Ky seminar ka shërbyer si një platformë që palët e interesuara t'i shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre fillestare, të cilat janë dokumentuar me përpikëri dhe janë marrë parasysh në fazat e mëpasshme të planifikimit.

Janë mbajtur dy takime konsultative, me ç'rast janë mbledhur së bashku një gamë të gjerë palësh të interesuara nga sektorë të ndryshëm. Këto takime kanë shërbyer si sesione informimi lidhur me progresin dhe për dhënie të fidbekut, në të cilat palët e interesuara janë informuar për zhvillimet në ecuri dhe kanë pasur mundësinë të japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Të gjitha komentet janë shqyrtuar me kujdes dhe janë integruar në planin e veprimit.

#### **Përfshirja e hershme:**

**Seminaret konsultative:** Organizim i seminarëve me palët kryesore të interesuara në fillim të fazës së planifikimit për të mbledhur të dhëna dhe për të siguruar pranim nga ana e tyre.

**Vlerësimi i nevojave:** Vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave duke përfshirë të gjitha palët e interesuara për t'i identifikuar prioritetet, kapacitetet dhe mangësitë.

#### **Planifikimi bashkëpunues:**

**Grupet e punës:** Themelim i grupeve të punës me shumë palë me qëllim që bashkërisht të zhvillohet plani i veprimit. Përfshirje e përfaqësuesve nga të gjitha grupet kryesore të palëve të interesuara.

**Vendimmarrja e përbashkët:** Të sigurohet që vendimet të miratohen në frymën e bashkëpunimit, me të dhëna nga të gjitha palët relevante, për të nxitur pronësi dhe përgjegjësi.

#### **Komunikimi i rregullt:**

**Informimet për progresin:** Bëhen informime të rregullta për progresin me planifikimin dhe zbatimin përmes takimeve, buletineve dhe platformave onlajn.

**Mekanizmat për fidbek:** Krijim i kanaleve si sondazhe, fokus grupe dhe forume publike për palët e interesuara me qëllim që vazhdimisht të japin komente dhe sugjerime.

#### **Ngritja e kapaciteteve:**

**Programet e trajnimit:** Ofrohen programe për trajnime dhe për ngritje të kapaciteteve për palët e interesuara, duke u fokusuar në rezistencën ndaj klimës, praktikave të qëndrueshme dhe menaxhimin e të dhënave.

**Shkëmbimi i resurseve:** Shkëmbim i resurseve, mjeteve dhe praktikave më të mira mes palëve të interesuara për të ndërtuar kapacitete dhe njohuri kolektive.

#### **Monitorimi dhe vlerësimi:**

**Përfshirja e palëve të interesuara në Monitorim dhe Vlerësim:** Përfshirje e palëve të interesuara në proceset e monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

**Menaxhimi adaptiv:** Të përdoret fidbeku nga palët e interesuara për t'i bërë rregullimet e nevojshme në planin e veprimit dhe për të përmirësuar efektivitetin e tij.

**Partneritetet dhe Bashkëpunimi:**

**Marrëveshjet formale:** Themelim i partneriteteve formale dhe memorandumë mirëkuptimi për përcaktimin e roleve, përgjegjësi dhe mekanizmave për bashkëpunim.

**Bashkëpunimi Ndërsektorial:** Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm (p.sh. shëndetësia, mjedisi jetësor, energjetika) për integrimin e përpjekjeve dhe për nxitjen e sinergjive.

**Angazhimi i publikut dhe Përfaqësimi (Avokimi):**

**Fushatat për ngritjen e vetëdijes:** Realizimi i fushatave për ngritjen e vetëdije së publikut për të informuar dhe angazhuar komunitetin më të gjerë lidhur me rreziqet shëndetësore që ndërlidhen me klimën dhe rëndësinë e masave për rezistencë ndaj ndikimeve klimatike.

**Përpjekjet për përfaqësim:** Përfaqësim për politikat përkrahëse dhe rritjen e fondeve për iniciativat për rezistencë ndaj ndikimeve klimatike dhe dekarbonizimin në sektorin e shëndetësisë.

## 6 Qeverisja dhe Korniza Institucionale

### 6.1 Strukturat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit

Qeverisja efektive dhe kornizat institucionale janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të planit të veprimit për rezistencë ndaj kushteve klimatike dhe dekarbonizimin në sektorin e shëndetësisë. Këto struktura sigurojnë koordinimin e aktiviteteve, monitorimin e progresit dhe përbushjen e objektivave.

**Komiteti Drejtues:**

**Funksioni:** Ofron udhëheqje strategjike, mbikëqyrje dhe autoritet për vendimmarrje për planin e veprimit.

**Përbërja:** Përfshin përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Energjisë, e Minerave dhe e Burimeve Minerale, Ministria e Financave dhe organet tjera përkatëse.

**Përgjegjësitë:** Miratimi i politikave, ndarja e resurseve dhe shqyrtimi i raporteve të progresit.

### **Pika Fokale/Njësia e Koordinimit:**

**Funksioni:** Vepron si seli qendrore për koordinimin e të gjitha aktiviteteve në lidhje me planin e veprimit.

**Vendndodhja e selisë:** Idealisht në suazat e MSH-së ose Institutit të Shëndetësisë Publike (ISHP).

**Përgjegjësitë:** Menaxhimi i planit të veprimit në bazë ditore, ndërlidhje me palët e interesuara dhe sigurimi i integritetit me politikatat e tjera nacionale.

### **Grupet Teknike të Punës:**

**Funksioni:** Ofrojnë ekspertizë dhe mbështetje të specializuar për aspekte të ndryshme të planit të veprimit, sikur efikasiteti energjetik, menaxhimi i hedhurinave dhe monitorimi i sëmundjeve.

**Përbërja:** Përfshin ekspertë nga fusha përkatëse, duke përfshirë akademikë, studiues dhe praktikues.

**Përgjegjësitë:** Zhvillimi i udhëzimeve teknike, kryerja e kërkimeve dhe këshillim për praktikatat më të mira.

### **Korniza e Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V):**

**Funksioni:** Gjurmon progresin, mat rezultatet dhe siguron llogaridhënie.

**Komponentët:** Përfshihen treguesit, metodat e mbledhjes së të dhënave dhe kalendari i raportimit.

**Përgjegjësitë:** Vlerësimi i rregullt i efektivitetit të intervenimeve, identifikimi i sfidave dhe dhënia e rekomandimeve për të bërë përshtatje.

## **6.2 Rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe institucioneve të ndryshme**

Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësisë të aktorëve dhe institucioneve të ndryshme ka rëndësi thelbësore për veprim të koordinuar dhe efektiv. Çdo palë e interesuar ka një rol specifik që kontribuon në suksesin e përgjithshëm të planit të veprimit.

### **Ministria e Shëndetësisë (MSH):**

**Roli:** Institucioni kryesor përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe zbatimin e planit të veprimit.

**Përgjegjësitë:** Zhvillimi i politikave, shpërndarja e resurseve dhe integrimi i qëndrueshmërisë klimatike në strategjitë e sektorit shëndetësor.

**Instituti i Shëndetit Publik (ISHP):**

**Roli:** Institucioni përgjegjës për zbatimin e programeve për rezistencë ndaj klimës.

**Përgjegjësitë:** Zhvillimi i kërkimeve, mbledhja e të dhënave dhe monitorimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike mbi shëndetin.

**Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor:**

**Roli:** Bashkëpunëtor për politikat dhe nismat ekologjike.

**Përgjegjësitë:** Ofron ekspertizë për përshtatjen dhe zbutjen e ndikimeve klimatike, duke i përkrahur iniciativat për shëndetin mjedisor.

**Ministria e Energjisë, e Minerave dhe e Burimeve Minerale:**

**Roli:** Përkrahje e intervenimeve në lidhje me energjinë në sektorin e shëndetësisë.

**Përgjegjësitë:** Lehtësimi i qasjes në energjinë e rinovueshme dhe programet e efikasitetit energjetik, duke ofruar stimulime financiare.

**Ministria e Financave:**

**Roli:** Mbikëqyrja financiare dhe shpërndarja e resurseve.

**Përgjegjësitë:** Sigurimi i financimit për projektet për rezistencë ndaj ndikimeve klimatike, duke integruar perspektivat klimatike në proceset buxhetore.

**Vetëqeverisjet Lokale:**

**Roli:** Zbatimi i intervenimeve në nivel lokal.

**Përgjegjësitë:** Zbatimi i rregulloreve, angazhimi i komuniteteve dhe përkrahje për objektet shëndetësore lokale në përpjekjet për qëndrueshmëri.

**Organizatat Joqeveritare (OJQ):**

**Roli:** Përfaqësim dhe përkrahje teknike.

**Përgjegjësitë:** Zhvillimi i fushatave për ngritjen e vetëdijes, realizimi i trajnimeve dhe përkrahje e iniciativave të bazuara në komunitet.

**Organizatat Ndërkombëtare dhe Donatorët:**

**Roli:** Financimi dhe asistenca teknike.

**Përgjegjësitë:** Ofron përkrahje financiare, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe sigurimin e resurseve për ndërtimin e kapaciteteve.

**Institucionet akademike dhe kërkimore:**

**Roli:** Hulumtimi dhe inovacioni.

**Përgjegjësitë:** Zhvillimi i studimeve mbi ndikimet klimatike, zhvillimi i zgjidhjeve inovative dhe trajnimi i profesionistëve shëndetësorë.



## Sektori Privat:

**Roli:** Investimi dhe inovacioni.

**Përgjegjësitë:** Zbatimi i praktikave të qëndrueshme, investimi në teknologjitë e gjelbra dhe bashkëpunimi në projektet e dekarbonizimit.

## 7 Fushat e Veprimit dhe Strategjitë

### 7.1 Përshkrimi i detajuar i veprimeve specifike që duhen ndërmarrë në sektorët kryesorë

Është zhvilluar një pyetësor i cili është ndarë me 93 institucione. Ky pyetësor përfshin një sërë pyetjesh të hapura, gjithsej 42 pyetje. Numri i përgjigjeve që i kemi fituar arriti 65. Mbledhja e aktivitetit është bërë nga shkurti deri në prill të vitit 2024 pas konsultimit me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, si dhe shabllonet e zhvilluara të Agjencisë për Energjetikë që janë përdorur në vitet e mëparshme. Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve, kontakteve personale dhe hulumtimit mbi dokumentet për prokurime publike që ishin në dispozicion, vendosin bazën e këtij plani të veprimit. Synimi ishte që të mbulohej i gjithë sektori publik i shëndetësisë, duke përfshirë objektet e kujdesit primar shëndetësor.

### 7.2 Infrastruktura dhe objektet shëndetësore

#### 7.2.1 Qeverisja

Qeverisja është thelbësore për zbatimin e suksesshëm të planit të veprimit për dekarbonizimin e sektorit shëndetësor, sepse me të sigurohet udhëheqje e qartë, sigurohet llogaridhënie dhe e integron planin me politika të tjera. Me të lehtësohet shpërndarja e burimeve, angazhimi i palëve të interesuara dhe monitorimi i vazhdueshëm, ndërkohë që i menaxhon rreziqet dhe e përmbush aspektin e konformitetit. Qeverisja efektive siguron që plani të zbatohet në mënyrë efikase, të qëndrojnë në rrugën e duhur dhe t'i përmbush synimet e tij për qëndrueshmëri.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Dedikimi ndaj neutralitetit klimatik dhe qëndrueshmërisë klimatike</b>	1. Përfshirje e neutralitetit klimatik dhe qëndrueshmërisë klimatike në deklaratën/vizionin e misionit; 2. Identifikimi i Pikës fokale për Çështje Klimatike (PFÇK) në sektorin shëndetësor; 3. Koordinim i veprimeve klimatike në sektorin shëndetësor;	Të koordinohen aktivitetet klimatike në sektorin shëndetësor	Të përfshirë në Deklaratën e misionit; PFÇK e themeluar dhe aktive Numri i takimeve koordinuese në nivel vjetor



<p><b>Menaxhimi i njohurive</b></p>	<p>1. Trajnimi i punonjësve për temën e mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë klimatike; 2. Përcaktim i një zyrtari përgjegjës për çështje mjedisore/klimatike në çdo spital publik; 3. Trajnimi i punonjësve për temën e “sëmundjeve që kanë të bëjnë me klimën”; 4. Të sigurohen informacione për pacientët, p.sh. njoftim apo ngjarje informative.</p>	<p>Të rritet niveli i edukimit lidhur me çështjet klimatike dhe qëndrueshmërinë si dhe të ngritet vetëdija për nevojën për të vepruar</p>	<p>Numri i trajnimeve në nivel vjetor; Numri i zyrtarëve për çështje klimatike; Mbatje e evidencës</p>
<p><b>Monitorimi</b></p>	<p>1. Vendosja e një sistemi për emetimet e GS-ve me qëllim që të monitorohet progresi; 2. Me ligj të përcaktohet detyrimi për raportim mbi përdorimin e të dhënave për një numër të madh institucionesh shëndetësore;</p>	<p>Të lejohet monitorim i progresit në përmbushjen e synimeve afatgjata për neutralitet klimatik</p>	<p>Raportim vjetor për GS-të</p>



## 7.2.2 Përmirësimet e Efikasitetit Energjetik

Zbatimi i praktikave dhe teknologjive për efikasitet energjetik në objektet shëndetësore për të reduktuar konsumin e energjisë dhe emetimin e gazrave serë.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Auditime të detajuara energjetike</b>	Identifikimi i fushave për përmirësim në konsumin e energjisë dhe përforcimin e efikasitetit energjetik në objektet shëndetësore.	1. Kryerja e vlerësimeve të thella mbi tendencat aktuale të konsumit të energjisë. 2. Identifikimi i pikave të joefikasitetit dhe fushave potenciale për kursim të energjisë. 3. Zhvillimi i raporteve të detajuara me rekomandime për masat për kursim të energjisë.	Numri i auditimeve të zhvilluara energjetike, përqindja e identifikuar e kurseve energjetike.
<b>Përmirësim i sistemeve për ndriçim me efikasitet energjetik</b>	Reduktimi i konsumit të energjisë nëpërmjet zëvendësimit të ndriçimit tradicional me poça LED.	1. Vlerësimi i sistemeve të tanishme të ndriçimit. 2. Prokurim dhe instalim i poçave LED. 3. Trajnimi i personelit për praktikën e kursimit energjetik në lidhje me sistemet e ndriçimit.	Reduktimi i konsumit të energjisë për ndriçim, numri i poçave LED të instaluar.
<b>Përmirësimi i sistemeve HVAC</b>	Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe cilësisë së ajrit brenda hapësirave të mbyllura (ajri i brendshëm) nëpërmjet përmirësimit të sistemeve HVAC.	1. Vlerësim i sistemeve të tanishme HVAC. 2. Prokurim dhe instalim i njësisve HVAC me efikasitet energjetik. 3. Trajnim i personelit për mënyrën e funksionimit të sistemeve reja dhe për mirëmbajtjen e tyre.	Reduktimi i konsumit të energjisë për sistemet HVAC, përmirësimi i cilësisë së ajrit të brendshëm.
<b>Izolimi i mbështjellës të ndërtesave</b>	Reduktimi i nevojave për ngrohje dhe ftohje nëpërmjet përmirësimit të izolimit në objektet shëndetësore.	1. Zhvillimi i sondazheve termike për t'i identifikuar pikat e humbjes së nxehtësisë. 2. Instalimi i materialeve me cilësi të lartë izolimi në muret, kulmet dhe dyshetet. 3. Izolimi i dritareve dhe dyerve për të parandaluar rrjedhjen e ajrit të klimatizuar.	Reduktimi i konsumit të energjisë për ngrohje dhe ftohje, përmirësim në rregullimin e temperaturës në hapësirat e mbyllura.
<b>Dritare dhe xham me efikasitet energjetik</b>	Përmirësimi i efikasitetit energjetik nëpërmjet përmirësimit të dritareve dhe izolimit të xhamit për të zvogëluar humbjen e nxehtësisë.	1. Vlerësim i dritareve aktuale dhe instalimit të tyre. 2. Instalim i dritareve me xham të dyfishtë ose të trefishtë. 3. Aplikim i mbështjellësve me shkallë të ulët të emitimit (Low-E) në dritaret.	Reduktim i konsumit të energjisë për ngrohje dhe ftohje.
<b>Sisteme të mençura të menaxhimit të ndërtesave</b>	Për optimizimin e konsumit të energjisë nëpërmjet teknologjive të avancuara për menaxhim të ndërtesave.	1. Instalim i njëjsorëve dhe sensorëve të zgjuar për monitorimin e konsumit të energjisë. 2. Implementim i aparateve për kontroll të automatizuar për ndriçim. 3. Shfrytëzimi i analizave mbi të dhënat për identifikimin dhe adresimin e çështjeve të joefikasitetit.	Përmirësime në matjen e efikasitetit energjetik, reduktim i kostove operative.
<b>Sistemet e ngrohjes së ujit me efikasitet energjetik</b>	Për reduktimin e konsumit energjetik nëpërmjet përmirësimit të sistemeve për ngrohje më efikase të ujit.	1. Instalimi i sistemeve diellore për ngrohje të ujit. 2. Përmirësimi i bojlerëve me afikasitet energjetik dhe pompave të ngrohjes. 3. Përdorimi i pajisjeve për kursim të ujit.	Reduktim i harxhimit të energjisë për ngrohje të ujit, kursim i kostove në faturat për energji elektrike.
<b>Bashkëgjenerim mikro dhe i vogël</b>	Për implementimin e sistemeve mikro dhe të vogla për bashkëgjenerim për rritjen e efikasitetit energjetik dhe për të reduktuar emetimet e gazrave serë.	Instalim i sistemeve për bashkëgjenerim mikro dhe të vogël (me kombinimin ngrohje dhe energji) aty ku ka mundësi. Kjo përfshin zhvillimin e studimeve për realizueshmëri, përzgjedhjen e njësisve të duhura për bashkëgjenerim dhe integrimin e këtyre sistemeve me infrastrukturën ekzistuese.	Numri i njësisve të instaluar për bashkëgjenerim.



## 7.2.3 Integrimi i Energjisë së Rinovueshme

Përfshirja e burimeve të rinovueshme të energjisë për furnizimin energjetik të objekteve shëndetësore, në këtë mënyrë duke e reduktuar varësinë nga lëndët djegëse fosile.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Instalimi i paneleve solare në çati apo ferma solare në lokacion</b>	Për prodhim të elektricitetit duke përdorur energjinë diellore, duke reduktuar mbështetjen në infrastrukturën dhe duke reduktuar shpenzimet për energji.	<ol style="list-style-type: none"> <li>Zhvillim i vlerësimit të zonave për përcaktimin e lokacioneve optimale për panelet solare.</li> <li>Instalimi i sistemeve fotovoltaike (PV) me fuqi deri në 40 kW në kulmet e objekteve përkatëse apo në lokacionet përreth tyre.</li> <li>Integrimi i sistemeve të energjisë diellore me infrastrukturën ekzistuese elektrike.</li> <li>Trajnimi i personelit për mirëmbajtjen dhe monitorimin e instalimeve për energji solare.</li> </ol>	Sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga energjia diellore. Një sistem me fuqi prej 40kW mund të gjenerojë përafërsisht 50,000 kWh në vit, varësisht prej lokacionit dhe efikasitetit të sistemit.
<b>Instalimi i turbinave eolike</b>	Shfrytëzimi i energjisë eolike për prodhim të energjisë elektrike, duke reduktuar emetimet e karbonit dhe harxhimet për energji.	<ol style="list-style-type: none"> <li>Instalimi i turbinave eolike me madhësi mesatare në rastet kur kjo është e realizueshme.</li> <li>Integrimi i sistemeve energjetike me infrastrukturën elektrike.</li> <li>Trajnimi i personelit për mirëmbajtjen dhe monitorimin e turbinave të erës.</li> </ol>	Sasia e energjisë elektrike të prodhuar nga energjia e erës (kWh), reduktim në konsumin nga rrjeti i energjisë elektrike.
<b>Sistemet gjeotermale për ngrohje dhe ftohje</b>	Implementimi i sistemeve gjeotermale për ngrohje dhe ftohje, zvogëlimi i shkallës së mbështetjes në burimet tradicionale të energjisë dhe përforsimi i efikasitetit energjetik.	<ol style="list-style-type: none"> <li>Kryerja e vlerësimeve gjeotermale për t'i identifikuar lokacionet e përshtatshme.</li> <li>Instalimi i pompave gjeotermale për ngrohje dhe i infrastrukturës përkatëse.</li> <li>Trajnim i personelit për mënyrën e funksionimit të sistemeve gjeotermale dhe për mirëmbajtjen e tyre.</li> </ol>	Reduktimi i konsumit të energjisë për ngrohje dhe ftohje, përmirësimi në cilësinë e klimës së brendshme.
<b>Akumulimi (depozitimi) në bateri</b>	Për akumulimin e energjisë së pashfrytëzuar të gjeneruar nga burimet e rinovueshme për shfrytëzim në periudhat e kërkesave më të larta dhe ndërprerjeve të furnizimit me rrymë, forcimi i sigurisë së efikasitetit energjetik.	<ol style="list-style-type: none"> <li>Vlerësimi i nevojave dhe potencialeve për akumulim të energjisë.</li> <li>Prokurimi dhe instalimi i sistemeve të akumulimit në bateri.</li> <li>Integrimi i akumulimit në bateri me sistemet e energjisë diellore dhe të erës.</li> <li>Trajnimi i personelit për mënyrën e funksionimit të sistemeve të akumulimit në bateri dhe për mirëmbajtjen e tyre.</li> </ol>	Kapaciteti i instaluar i akumulimit (depozitimit): Zakonisht, një sistem PV diellor prej 40kW do të ketë nevojë për një bateri me kapacitet prej rreth 80kWh për akumulimin e sasisë së gjeneruar të rënditore, varësisht prej regjimeve të përdorimit dhe teknologjisë së akumulimit.



## 7.2.4 Dizajne rezistente ndaj klimës

Projektimi i objekteve shëndetësore që mund t'u bëjnë ballë ndikimeve klimatike dhe sigurojnë vazhdimësi të kujdesit në kushteve ekstreme të motit.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Mbrojtje nga vërshimet</b>	Mbrojtje gjithëpërfshirëse nga vërshimet për objektet e kujdesit shëndetësor.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryerje e vlerësimit të rreziqeve nga vërshimet për objektet e kujdesit shëndetësor.</li> <li>2. Rritja e komponentëve kryesorë të ndërtesave dhe objekteve në zonat që janë më të ekspozuara ndaj rrezikut prej vërshimeve.</li> <li>3. Instalimi i barrierave dhe pendave për mbrojtje nga vërshimet përreth objekteve të kujdesit shëndetësor që janë më të ekspozuara.</li> <li>4. Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemeve të kullimit për menaxhim me ujërat nga vërshimet.</li> <li>5. Trajnim i personelit për gatishmëri dhe përgjigje ndaj vërshimeve.</li> </ol>	Numri i objekteve të mbrojtura nga vërshimet, reduktimi në shpenzimet që ndërlidhen me dëmet e shkaktuar nga vërshimet.
<b>Materiale rezistente ndaj nxehtësisë</b>	Materiale dhe teknologji ndërtimore me rezistencë ndaj nxehtësisë.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësim i materialeve ndërtimore ekzistuese dhe identifikimi i fushave për përmirësim.</li> <li>2. Instalim i kulmeve të freskëta dhe përdorim i ngjyrave reflektuese në pjesën e jashtme të objekteve.</li> <li>3. Inkorporim i materialeve rezistente ndaj nxehtësisë në ndërtimet e reja dhe punimet e rinovimeve.</li> <li>4. Trajnimi i personelit për mirëmbajtje lidhur me aplikimin dhe përkujdesjen për materialet me rezistencë ndaj nxehtësisë.</li> </ol>	Ujje në temperaturat e brendshme, zvogëlim i konsumit të energjisë për klimatizim.
<b>Ajrimi natyral</b>	Të projektohen dhe adaptohen objektet për maksimizimin e ajrosjes natyrale, reduktimin e shkallës së mbështetjes në kondicionerë.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësim i ventilimit (ajrimit) për t'i identifikuar mundësitë për qarkullim të natyrshëm të ajrit.</li> <li>2. Projektimi dhe adaptimi i objekteve për të inkuorporuar teknika pasive të ventilimit.</li> <li>3. Instalimi i dritareve të manipulueshme, ventilacioneve dhe veglave tjera që e përforcojnë ventilimin.</li> <li>4. Trajnim i personelit të objekteve për optimizim të sistemeve të ventilimit natyral.</li> </ol>	Reduktimi i konsumit të energjisë për klimatizim, përmirësimi i cilësisë së ajrit në ambientet e mbyllura.
<b>Gatishmëria për raste të emergjencës</b>	Për t'u siguruar që objektet e kujdesit shëndetësor kanë sasi energjetike reserve, plane për reagim në situata emergjence dhe resurse adekuate për të vazhduar funksionimin gjatë katastrofave.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi dhe përditësimi i rregullt i planeve për reagim në situata emergjence.</li> <li>2. Instalimi i sasive për energji rezervë, si gjeneratorë dhe sisteme të akumulimit në bateri.</li> <li>3. Magazinimi i rezervave dhe resurseve më të rëndësishme për skenarë të rasteve të katastrofave.</li> <li>4. Ekzekutimi i stërvitjeve të rregullta për situatat emergjente me personelin dhe trajnimin i personelit.</li> <li>5. Vendosje e protokolleve për komunikim dhe mekanizmeve për koordinim me shërbimet lokale të emergjencës.</li> </ol>	Numri i objekteve me plane të përditësuara për reagim në situata emergjence, qasje tek sistemet për energjinë rezervë, personel i trajnuar për reagim në situata emergjence.



## 7.2.5 Ruajtja e Ujit

Zbatimi i masave të kursimit të ujit për të reduktuar konsumin e tij në objektet shëndetësore dhe për të siguruar resurse ujore në dispozicion gjatë thatësirave.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Instalim i pajisjeve me prurje të vogël si dhe detektim dhe ndreqje e defekteve të rrjedhjes</b>	Për reduktimin e konsumit të ujit, rrjedhjeve të ujit dhe promovimin e ruajtjes së ujit nëpërmjet instalimit të çezmave, tualeteve dhe paneleve (kokë) dushi me rrjedhje të vogël. Sanimi dhe ndërrimi i gypave të vjetra. Mirëmbajtje dhe ndërrim i rregullt i gypave të vjetër të ujësjellësit për të zvogëluar mundësinë e rrjedhjes dhe humbjes së ujit.	1. Vlerësime për identifikimin e pajisjeve aktuale dhe të rregjimeve të konsumit të ujit. 2. Kontrollë të rregullta të rrjetit: Aplikim i teknologjive moderne siç janë detektorët akustikë apo senzorët me presion për identifikimin e rrjedhjeve në gypat nëntokësorë të ujësjellësit. 3. Prokurim dhe instalim i çezmave, tualeteve dhe paneleve (kokë) dushi me rrjedhje të vogël. 4. Trajnimi i personelit të mirëmbajtjes si dhe i përdoruesve lidhur me përfitimet e përdorimit adekuat të pajisjeve me rrjedhje të vogël. 5. Përdorimi i materialeve me shkallë të lartë të qëndrueshmërisë. Ndërrimi i gypave të vjetër dhe të dëmtuar me materiale që janë më pak të brishta ndaj korrozionit dhe dëmtimeve mekanike.	Reduktimi i konsumit të ujit (litra në nivel ditor), numri i pajisjeve të instaluara me prurje të vogël.
<b>Instalim i sistemeve për shfrytëzimin e ujit nga reshjet</b>	Akumulimi dhe depozitimi i ujit nga reshjet që nuk është i pjishëm, pra për ujitje, larjen e tualeteve, reduktimi i shkallës së mbështetjes në furnizimin me ujë nga vetëqeverisja lokale.	1. Vlerësime të lokacionit për të përcaktuar realizueshmërinë e shfrytëzimit të ujit prej reshjeve. 2. Instalimi i sistemeve për akumulimin e ujit nga reshjet, duke përfshirë ulluqe, rezervoarë për akumulim dhe njësi filtrimi. 3. Integrimi i sistemeve për ujë prej reshjeve me ujësjellësin ekzistues që nuk është për ujë të pjishëm. 4. Trajnimi i personelit për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve për shfrytëzimin e ujit nga reshjet.	Sasia e ujit të akumuluar nga reshjet dhe të shfrytëzuar (litra në nivel vjetor), reduktimi i konsumit të ujit që sigurohet nga ndërmarrjet komunale.
<b>Rregullim i truallit për efikasitet ujqor</b>	Minimizimi i konsumit të ujit në truallin e objektit duke përdorur bimë endemike dhe teknika për konsum të vogël të ujit (XERISCAPING).	1. Projektim i planeve për rregullim të truallit për efikasitet ujqor duke përdorur bimë endemike dhe bimë rezistente ndaj thatësirës. 2. Mënjanimi i bimëve dhe barrit me konsum intensiv të ujit. 3. Instalimi i sistemeve efikase për ujitje, si ujitja pikë-pikë. 4. Trajnimi i personelit për (XERISCAPING) teknikat për rregullimin e truallit dhe mirëmbajtje.	Reduktimi i konsumit të ujit (litra në nivel vjetor), përqindja e sipërfaqes së të kultivuar në peizazh që nuk ka nevojë për ujitje.
<b>Sipërfaqet e gjelbra</b>	1. Të shmangët mbyllja e sipërfaqeve; 2. Mbrojtje dhe zgjerim i sipërfaqeve të gjelbra	Kjo masë përfshin zhvillimin, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra në institucionet e kujdesit shëndetësor. Synimi i saj është përmirësimi i cilësisë mjedisore, forcimi i biodiversitetit dhe promovimi i shëndetit publik nëpërmjet rritjes së kuantitetit të vegjetacionit natyral dhe sipërfaqeve për rekreacion të publikut. Kjo përfshin mbjelljen e drunjve, krijimin e parqeve, korridoreve të gjelbra dhe kulmeve të gjelbra, si dhe mbrojtjen e habitateve natyrore nga urbanizimi dhe degradimi. Kjo masë e ndihmon rezistencën ndaj klimës nëpërmjet zvogëlimit të ishujve urban të nxehtësisë, përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe sigurimit të hapësirave për aktivitete shoqërore dhe të komuniteteve.	m <sup>2</sup> të sipërfaqeve të mbyllura; m <sup>2</sup> të sipërfaqeve të gjelbra

## 7.2.6 Transport i qëndrueshëm

Promovimi i opsioneve të qëndrueshme të transportit për të reduktuar emetimet nga aktivitetet e transportit që ndërlidhen me mbrojtjen shëndetësore.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Tranzicioni në Autoambulanca dhe automjete elektrike të shërbimit shëndetësor</b>	Reduktimi i emetimeve të gazrave serë dhe shpenzimeve operative nëpërmjet përdorimit të autoambulancave dhe automjeteve elektrike të shërbimit përkatës.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësim i flotës aktuale të autoambulancave dhe automjeteve të shërbimit shëndetësor.</li> <li>2. Prokurim i automjeteve elektrike (AE) dhe infrastrukturës së nevojshme për karikim.</li> <li>3. Trajnim i shoferëve dhe personelit për mirëmbajtje lidhur me funksionimin dhe përkujdesjen për AE-të.</li> <li>4. Monitorimi dhe raportimi për performansin dhe përfitimet nga flota e AE-ve.</li> <li>5. Instalimi i pikave për karikimin e AE-ve në spital mund t'i inkurajojë pacientët, personelin dhe vizitorët të përdorin automjete elektrike.</li> </ol>	Numri i automjeteve elektrike në përdorim të shërbimit, reduktimi në konsumin e karburanteve dhe emetimet (CO <sub>2</sub> ekuivalenti).
<b>Stimulime për personelin dhe pacientët që ta përdorin transportin publik, automjete elektrike, biçikleta ose transport të përbashkët përmes biletave të subvencionuara, bonuseve apo benefiteve tjera.</b>	Reduktimi i gjurmës mjedisore të objekteve të kujdesit shëndetësor përmes inkurajimit të personelit dhe pacientëve që ta përdorin transportin publik.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi i programeve për subvencione për bileta ose stimulime tjera që punonjësit shëndetësorë dhe pacientët të përdorin transportin publik.</li> <li>2. Bashkëpunim me autoritetet lokale për transport publik me qëllim që të përmirësohen itineraret e përfshira në shërbimet e tyre deri te objektet e kujdesit shëndetësor.</li> <li>3. Realizimi i fushatave për ndërgjegjësim lidhur me përfitimet nga përdorimi i transportit publik.</li> </ol>	Rritja në përdorimin e transportit publik nga personeli dhe pacientët, reduktimi në përdorimin e veturave individuale.
<b>Zhvillimi i infrastrukturës për biçikleta</b>	Për inkurajim të përdorimit të biçikletave si formë e qëndrueshme transporti nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës siç janë pikat për t'i lidhur biçikletat dhe objektet për dush.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Instalimi i rafteve dhe hapësirave të sigurta për t'i lidhur biçikletat në qendrat e kujdesit shëndetësor.</li> <li>2. Ndërtimi dhe përmirësimi i hapësirave për dush dhe ndërrimin e teshave për punonjësit të cilët në punë shkojnë me biçikletë.</li> <li>3. Promovimi i përdorimit të biçikletave nëpërmjet fushatave për ngritjen e vetëdijes dhe programeve për stimulim.</li> </ol>	Numri i punonjësve, të cilët në punë shkojnë me biçikletë, përdorimi i hapësirave për biçikleta, reduktimi në emetimet nga transporti.
<b>Sisteme të automatizuara për menaxhim të komunikacionit rrugor dhe parkimit</b>	Për reduktimin e trafikut të dendur dhe emetimet e CO <sub>2</sub> në rrethinën e spitaleve të mëdha dhe qendrave klinike duke e optimizuar qarkullimin dhe parkimin e automjeteve përmes sistemeve të automatizuara, përfundimisht duke e përmirësuar qasjen tek objektet e kujdesit shëndetësor dhe duke e reduktuar impaktin mjedisor të trafikun që ndërlidhet me spitalet.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Instalim i sensorëve inteligjent për parkim;</li> <li>2. Sinjalizim digjital dhe sisteme për gjetjen e rrugëve;</li> <li>3. Barriera dhe sisteme të automatizuara për pagesë;</li> <li>4. Softuer për optimizimin e rrjedhës së komunikacionit rrugor;</li> <li>5. Integrim i aplikacioneve celulare;</li> <li>6. Identifikim i automatizuar i targave të regjistrimit (IATR)</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Reduktimi i kohëzgjatjes mesatare të nevojshme për të gjetur vendparkim;</li> <li>2. Reduktimi i emetimeve të CO<sub>2</sub>;</li> <li>3. Përmirësimi në rrjedhën e komunikacionit rrugor;</li> <li>4. Satisfaksioni i pacientëve dhe vizitorëve: Matje në bazë të anketave për nivelin se sa janë të kënaqur lidhur me çështjen e parkimit dhe qasjes në spital.</li> </ol>
<b>Zgjerimi i shërbimeve telemjekësore</b>	Për zvogëlimin e nevojës për të udhëtuar deri në objektet e kujdesit shëndetësor, përmes zgjerimit të shërbimeve telemjekësore, në këtë mënyrë duke i reduktuar emetimet që ndërlidhen me transport dhe duke përmirësuar qasjen për kujdes shëndetësor.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi dhe implementimi i platformave dhe infrastrukturës për telemjekësi.</li> <li>2. Trajnim i dhënësve të kujdesit shëndetësorë për teknologjitë dhe praktikat më të mira të telemjekësisë.</li> <li>3. Promovim i shërbimeve telemjekësore për pacientët dhe integrimi i tyre në praktikat standarde të kujdesit.</li> <li>4. Monitorim dhe vlerësim i efektivitetit dhe shërbimeve telemjekësore në dispozicion.</li> </ol>	Numri i konsultimeve përmes telemjekësisë, reduktimi i udhëtimeve të pacientëve, përmirësimi i qasjes në kujdesin shëndetësor dhe niveli sa janë të kënaqur shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve.



## 7.2.7 Reduktimi dhe trajtimi i hedhurinave

Menaxhimi efektiv i hedhurinave nga sektori i kujdesit shëndetësor është thelbësor për reduktimin e ndikimit mbi mjedisin, mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurimin e operacioneve të qëndrueshme në sektorin shëndetësor.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Reduktimi i hedhurinave</b>	Për minimizimin e kuantitetit të hedhurinave të gjeneruara nga objektet shëndetësore, duke promovuar qëndrueshmëri dhe duke e reduktuar impaktin mjedisor.	Digjitalizimi: Tranzitim në evidencat elektronike shëndetësore (EESH) për reduktimin e hedhurinave prej letrës. Aktivitetet: Digjitalizimi i evidencave të pacientëve, implementimi i sistemeve digjitale të komunikimit dhe realizimi i trajnimeve për personelin lidhur me përdorimin e veglave digjitale. Benefitet: Reduktimi i nevojës për grumbullimin fizik të dokumenteve dhe minimizim të përdorimit të letrës. Shembulli: Një spital mund të kalojë nga mbajtja e evidencës në letër për pacientët në sistem digjital, duke e zvogëluar konsiderueshëm gjenerimin e hedhurinave prej letrës.	Reduktimi i hedhurinave prej letrës (kg në nivel mujor), numri i evidencave digjitale të implementuara.
<b>Blerja me shumicë</b>	Për minimizimin e hedhurinave të gjeneruara nga objektet shëndetësore.	Aktivitetet: Identifikim i rezervave që përdoren më shpesh, negociata për marrëveshje për blerje me shumicë me furnizuesit dhe efektivitet në zgjidhjet për magazinim. Benefitet: Reduktim i materialeve për paketim dhe emetimeve nga transporti. Shembulli: Spitalet mund të porosisin sasi me shumicë të produkteve që përdoren më shpesh, si p. sh. dorëza, kështu duke e zvogëluar sasinë e hedhurinave të gjeneruara nga paketimi.	Zvogëlim i hedhurinave nga paketimet (kg në nivel mujor), harxhime të zvogëluara me blerjet me shumicë.
<b>Kontejnerë për shumëfishhtë përdorim të</b>	Për minimizimin e vëllimit të hedhurinave të gjeneruara nga objektet shëndetësore.	Aktivitetet: Sigurimi i kontejnerëve të qëndrueshëm, me përdorim të shumëfishhtë, instalimi i proceseve për pastrim dhe sterilizim dhe edukimi i personelit për përdorimin e tyre. Benefitet: Zvogëlimi i hedhurinave prej plastmase të gjeneruara nga përdorimi i njëfishhtë. Shembulli: Spitalet mund të vendosin kontejnerë me përdorim të shumëfishhtë për sende sikur instrumentet kirurgjike, ilaçet dhe shërbimet ushqimore.	Reduktimi i hedhurinave prej plastmase nga përdorimi i njëfishhtë (kg në nivel mujor), numri i kontejnerëve për përdorim të shumëfishhtë që janë në funksion.
<b>Instrumente sterilizueshme kirurgjike të</b>	Për minimizimin e vëllimit të hedhurinave të gjeneruara nga objektet shëndetësore.	Aktivitetet: Prokurimi i instrumenteve të sterilizueshme me cilësi të lartë, trajnimi i personelit për teknikat e duhura të sterilizimit dhe mbikëqyrja e aspektit të konformitetit. Benefitet: Reduktimi i nevojës për instrumente me një përdorim. Shembulli: Spitalet mund të investojnë në instrumente kirurgjike me përdorim të shumëfishhtë, që mund të sterilizohen dhe të përdoren sërish, duke e zvogëluar kuantitetin e hedhurinave medicinale.	Reduktimi i hedhurinave prej instrumenteve me përdorim të njëfishhtë kirurgjik (kg në nivel mujor), numri i instrumenteve me përdorim të shumëfishhtë që janë në operativitet.
<b>Menaxhim efikas të inventarit</b>	Për minimizimin e vëllimit të hedhurinave të gjeneruara nga objektet shëndetësore.	Aktivitetet: Implementimi i softuerit për menaxhim të inventarit, trajnimi i personelit për praktikat më të mira me inventar dhe revizion i rregullt i niveleve të rezervave. Benefitet: Reduktimi i hedhurinave nga artikujt me afat të skaduar ose që nuk janë përdorur. Shembulli: Spitalet mund të përdorin softuer për menaxhim të inventarit për të monitoruar nivelin e përdorimit dhe datat e skadencës së materialeve medicinale, duke u siguruar që materialet të përdoren para skadimit të afatit të tyre.	Reduktimi i materialeve medicinale me afat të skaduar (kg në nivel mujor), përmirësimi në shkallën e përdorimit të inventarit.





Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Trajnimi i personelit për reduktimin e hedhurinave</b>	Për minimizimin e vëllimit të hedhurinave të gjeneruara nga objektet shëndetësore.	Aktivitetet: Zhvillimi i programeve për trajnim, zhvillimi i punëtorëve të rregullta dhe sigurimi i resurseve dhe udhëzimeve për reduktimin e hedhurinave. Benefitet: Rritja e shkallës së vetëdijes dhe konformitetit lidhur me praktikën e reduktimit të hedhurinave. Shembulli: Spitalet mund të zhvillojnë sesione trajnimi për personelin në lidhje me klasifikimin adekuat të hedhurinave, me praktikën e reciklimit dhe përdorimin e mjeteve me përdorim të shumëfishtë.	Numri i punonjësve të trajnuar, përmirësimi në praktikën e klasifikimit të hedhurinave, reduktimi në sasinë e përgjithshme të hedhurinave të gjeneruara (kg në nivel mujor).
<b>Klasifikimi në vendin e përdorimit</b>	Për të siguruar menaxhimin, trajtimin dhe hedhjen adekuate të hedhurinave medicinale, duke minimizuar efektin mjedisor dhe duke e mbrojtur shëndetin publik.	Aktivitetet: Vendosja e protokolleve për klasifikimin e hedhurinave, të vendosen shportat me ngjyra-kod për llojet e ndryshme të hedhurinave (p.sh., hedhurina të përgjithshme, hedhurina infektive, hedhurina të rrezikshme) si dhe trajnimi i personelit për praktikën adekuate të klasifikimit. Benefitet: Reduktim i rrezikut nga kontaminimi i ndërsjellë dhe sigurohet që hedhurinat trajtohen dhe hidhen në mënyrën e duhur. Shembulli: Spitalet mund të implementojnë sisteme klasifikimi, sipas të cilave hedhurinat infektive futen në shportat me ngjyrë të kuqe, hedhurinat e rrezikshme në shportat me ngjyrë të verdhë ndërsa hedhurinat e përgjithshme në shportat e zezë.	Përqindja e hedhurinave të klasifikuara në mënyrën e duhur, zvogëlimi i numrit të incidenteve të kontaminimit të ndërsjellë.
<b>Trajtimi adekuat</b>	Për të siguruar menaxhimin, trajtimin dhe hedhjen adekuate të hedhurinave medicinale, duke minimizuar efektin mjedisor dhe duke e mbrojtur shëndetin publik.	Aktivitetet: Implementimi i metodave adekuate për trajtimin e llojeve të ndryshme të hedhurinave, si përdorimi i autoklavave për hedhurinat infektive, trajtim kimik për hedhurinat e rrezikshme të lëngshme dhe djegia për llojet e caktuara të hedhurinave biomjekësore. Benefitet: Sigurohemi që hedhurinat trajtohen në mënyrë efektive dhe të sigurt, duke i zvogëluar rreziqet mjedisore dhe shëndetësore. Shembulli: Spitalet mund të instalojnë autoklava për trajtimin e hedhurinave infektive dhe të vendosin protokolle për trajtimin kimik të hedhurinave të rrezikshme të lëngshme.	Përqindja e hedhurinave të trajtuara duke zbatuar metodat përkatëse, zvogëlimi i sasisë së hedhurinave që nuk janë të trajtuara.
<b>Instalimi i inceneratorit të ri me sisteme të sofistikuar filtrimi</b>	Për zvogëlim të konsiderueshëm të emetimeve të CO <sub>2</sub> dhe ndotësve tjerë të dëmshëm që prodhohen nga inceneratori aktual duke e zëvendësuar atë me incenerator modern, i pajisur me sisteme të sofistikuar filtrimi. Synimi është që të sigurohet parimi i përgjegjësimit mjedisor gjatë hedhjes së hedhurinave medicinale ndërkaq duke e mbrojtur shëndetin publik.	1. Teknologji për djegie me efikasitet të lartë: Inceneratori i ri që përdor gjyp rrotullues me temperaturë të lartë ose sisteme të djegies me dy faza, i dizajnuar për djegjen e tërësishme të hedhurinave medicinale, reduktimin e CO <sub>2</sub> dhe shkarkimeve tjera të dëmshme. 2. Sisteme të sofistikuar filtrimi: Pastrues të gazrave: për neutralizimin e gazrave acidike siç janë SO <sub>2</sub> dhe HCl. Filtrat kryesorë: Për mënjanimin e materieve të grimcuara dhe reduktimin e shkarkimit të grimcave të imëta. Filtra të aktivizuar karboni: Për kapjen e dyoksinëve, furaneve dhe metaleve të rënda, duke siguruar që këta ndotës të mos përhapen në atmosferë. 3. Sisteme të monitorimit të vazhdueshëm mbi emetimet (CEMS): Instalimi i CEMS-ve për monitorimin e emetimeve në kohë reale, duke siguruar që inceneratori të funksionojë në suazat e limiteve të lejuara. Siguron të dhëna për konformitetin rregullor dhe adaptime operative për t'i minimizuar emetimet.	Reduktimi i emetimeve të CO <sub>2</sub> ; Të matura përmes zvogëlimit të emetimeve nga inceneratori para dhe pas instalimit të sistemit të ri. Reduktim në materiet grimca (PM) dhe ndotësit tjerë: Monitoruar nëpërmjet të dhënave për emetimet, duke paraqitur reduktim të konsiderueshëm të ndotësve siç janë dioksidi i sulfurit (SO <sub>2</sub> ), oksidet e azotit (NOx) dhe dyoksinet. Konformitet me standardet për emetime: Për të siguruar që inceneratori i ri në mënyrë konsekuente i përmbush standardet e emetimeve të përcaktuara në nivel nacional dhe të BE-së. Efikasiteti operativ: Vlerësim i performansit të inceneratorit në aspekt të procesimit të hedhurinave, rikthimit të energjisë dhe kohës gjatë së cilës nuk funksionon për shkak të mirëmbajtjes dhe teknike.
<b>Konformiteti me rregulloret</b>	Për të siguruar mënyrën e duhur të menaxhimit, trajtimit dhe hedhjes së hedhurinave medicinale, duke minimizuar efektin mjedisor dhe duke e mbrojtur shëndetin publik.	Aktivitetet: Të sigurohet respektim i rregulloreve dhe instruksioneve lokale, nacionale dhe ndërkombëtare për hedhjen e hedhurinave medicinale, si dhe revidim i rregullit i praktikave për t'u siguruar konformiteti. Benefitet: Të sigurohet që praktikën e menaxhimit të hedhurinave i përmbushin standardet ligjore dhe i mbrojnë shëndetin publik dhe mjedisin. Shembulli: Spitalet mund të vendosin sisteme për monitorim të konformitetit dhe të zbatojnë auditime të rregullta për të siguruar respektimin e rregulloreve për menaxhimin e hedhurinave.	Përqindja e konformitetit me rregulloret për menaxhimin e hedhurinave, numri i auditimeve të kryera me sukses.



## 7.2.8 Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm (EWS)

Ndërtimi i qëndrueshmërisë klimatike në sistemet e shëndetësisë publike është thelbësor për t'i zbutur ndikimet shëndetësore nga ndryshimet klimatike. Kjo nënkupton krijimin e sistemeve të fuqishme që mund t'u bëjnë ballë kërcënimeve shëndetësore që ndërlidhen me kushtet klimatike dhe të rikuperohen shpejt prej tyre. Sistemet e paralajmërimit të hershëm (EWS) janë qenësore për parashikimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve shëndetësore që ndërlidhen me rrethanat klimatike. Këto sisteme ofrojnë informacione të sakta dhe në kohë, që u mundëson dhënësve të kujdesit shëndetësor dhe komuniteteve të ndërmarrin masa proaktive për të mbrojtur shëndetin.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Sistemet e paralajmërimit të hershëm (EWS) për kërcënimet shëndetësore që janë në lidhje me kushtet klimatike</b>	Për zhvillimin dhe implementimin e një sistemi gjithëpërfshirës për paralajmërim të hershëm dhe përgjigje ndaj kërcënimeve shëndetësore që ndërlidhen me kushtet klimatike, në këtë mënyrë duke e mbrojtur shëndetin publik nëpërmjet mundësisit të përhapjes së informacioneve të sakta dhe me kohë si dhe masa proaktive.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përforcimi i sistemeve për monitorimin e sëmundjeve për detektimin e shenjave të hershme për sëmundjet sensitive ndaj klimës, siç janë sëmundjet e transmetuara nga vektorët (p.sh. malaria, dengoja) dhe sëmundjet e shkaktuara nga uji (p.sh. kolera). Kjo përfshin vendosjen e mekanizmave për monitorim dhe raportim nëpër objektet shëndetësore dhe integrim me databazat nacionale shëndetësore.</li> <li>2. Integrimi i të dhënave meteorologjike dhe shëndetësore për parashikimin dhe monitorimin e rreziqeve shëndetësore nga klima. Kjo përfshin vendosjen e protokolleve për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet autoriteteve meteorologjike dhe reparteve shëndetësore, si dhe zhvillimin e veglave analitike për monitorimin e ndryshoreve klimatike, siç janë temperatura dhe reshjet.</li> <li>3. Integrimi i të dhënave meteorologjike dhe shëndetësore për parashikimin dhe monitorimin e rreziqeve shëndetësore nga klima. Këtu përfshihet vendosja e protokolleve për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet autoriteteve meteorologjike dhe reparteve shëndetësore, si dhe zhvillimin e veglave analitike për monitorimin e ndryshoreve klimatike, siç janë temperatura dhe reshjet.</li> <li>4. Trajnimi i punonjësve shëndetësorë dhe pjesëtarëve të komuniteteve për mënyrën e reagimit ndaj paralajmërimeve të hershme dhe për të ndërmarrë veprime adekuate për parandalimin dhe zbutjen e efekteve shëndetësore. Kjo nënkupton zhvillimin e moduleve të trajnimit, realizimit të punëtorive dhe ekzekutimit të simulimeve dhe stërvitjeve të rregullta.</li> </ol>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i pikave të përcaktuara për monitorim;</li> <li>Numri i sistemeve të instaluar për të dhëna të integruara;</li> <li>Numri i mekanizmave të implementuar për alarmim;</li> <li>Numri i sesioneve të realizuara për trajnime.</li> </ul>

## 7.2.9 Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor

Përfshirja dhe edukimi i komuniteteve në lidhje me rreziqet shëndetësore nga klima dhe strategjitë për rezistencë është qenësore për gatishmërinë e shëndetit publik. Komunitetet e informuara dhe të fuqizuara mund të ndërmarrin hapa proaktivë për të mbrojtur shëndetin e tyre dhe për të kontribuar në rezistencën e përgjithshme.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Fushatat për vetëdijen publike</b>	Për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin lidhur me rreziqet shëndetësore që ndërlidhen me ndryshimet klimatike, duke i aftësuar individët dhe komunitetet të ndërmarrin masa proaktive për mbrojtjen e shëndetit të tyre.	Nisje e fushatave për vetëdijesimin e publikut duke përdorur kanale të ndryshme mediatike (TV, radio, mediat sociale, shtyp) për edukimin e publikut lidhur me rreziqet shëndetësore që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike dhe hapat që mund të ndërmerren për zbutjen e këtyre rreziqeve. Fushatat do të fokusohen në rreziqet nga valët e nxehtit, duke ofruar këshilla për të qenë të sigurt gjatë ngjarjeve ekstreme të motit.	Matja e mbulimit dhe përfshirjes për fushatat mediatike; Ngritja e vetëdijes publike dhe njohuri lidhur me rreziqet shëndetësore nga klima.
<b>Materiale edukative</b>	Për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin lidhur me rreziqet shëndetësore që ndërlidhen me ndryshimet klimatike, duke i aftësuar individët dhe komunitetet të ndërmarrin masa proaktive për mbrojtjen e shëndetit të tyre.	Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve edukative si broshura, posterë dhe resurse onlajn, që e shpjegojnë impaktin e ndryshimeve klimatike mbi shëndetin dhe ofrojnë këshilla praktike për individët dhe komunitetet.	Numri i materialeve edukative që janë shpërndarë.
<b>Trajnime për profesionistët shëndetësorë</b>	Për fuqizimin e kapacitetit të profesionistëve shëndetësorë për adresimin e çështjeve shëndetësore që ndërlidhen me kushtet klimatike.	Të ofrohen trajnime për dhënësit e kujdesit shëndetësor lidhur me impaktet nga ndryshimet klimatike, mënyrën si t'i identifikojnë dhe trajtojnë çështjet shëndetësore që ndërlidhen me klimën dhe si t'i këshillojnë pacientët për masat për adaptim ndaj kushteve klimatike.	Numri i profesionistëve shëndetësorë të trajnuar.

## 7.2.10 Përkrahja për popullatat e lëndueshme

Përkrahja për popullatat e lëndueshme përfshin identifikimin dhe adresimin e nevojave specifike të grupeve që ndikohen në mënyrë disproporcionale nga ndryshimet klimatike, ndër të cilët janë personat e moshuar, fëmijët, komunitetet me të ardhura të ulëta dhe ata me probleme kronike shëndetësore.



Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Identifikimi i grupeve të lëndueshme</b>	Për identifikimin dhe mbrojtjen e popullatave më të lëndueshme ndaj rreziqeve shëndetësore nga kushtet klimatike nëpërmjet intervenimeve të synuara, programeve të bazuara në komunitete, qasjes në shërbimet shëndetësore dhe gatishmërisë për situata emergjence.	Kryerje e vlerësimeve për identifikimin e popullatave më të lëndueshme ndaj rreziqeve shëndetësore nga kushtet klimatike të bazuara në faktorët sikur moshë, statusi socio-ekonomik dhe vendndodhja gjeografike.	Numri i vlerësimeve të kryera; Numri i grupeve të lëndueshme që janë identifikuar; Zonat gjeografike të hartëzuara.
<b>Intervenimet e synuara</b>	Për t'u siguruar që dekarbonizimi i sektorit të shëndetësisë është inkluziv dhe i drejtë nëpërmjet adresimit të nevojave dhe sfidave specifike të grupeve të lëndueshme, duke përfshirë komunitetet me të ardhura të ulëta, pacientët në moshë dhe ata me probleme kronike shëndetësore.	Zhvillimi dhe implementimi i intervenimeve me targetim për mbrojtjen dhe përkrahjen e grupeve të lëndueshme. Kjo mund të përfshijë të ofrohen qendra për freskim gjatë valëve të nxehtësisë, të përmirësohet cilësia e ajrit në vendbanimet me popullatë me të ardhura të ulëta dhe të sigurohet qasje për ujë të pastër.	Numri i intervenimeve me targetim që janë realizuar.

### 7.2.11 Prokurimet e Gjelbra në Sektorin e Shëndetësisë

Prokurimi i gjelbër në sektorin e shëndetësisë i referohet procesit të blerjes së produkteve, shërbimeve dhe punimeve në mënyrë që e minimizon ndikimin mjedisor dhe promovon qëndrueshmërinë. Kjo qasje është thelbësore për reduktimin e gjurmës së karbonit në objektet shëndetësore, duke promovuar përdorimin e materialeve të qëndrueshme dhe duke siguruar që proceset e kujdesit shëndetësor të jenë në përputhje me objektivat më të gjera mjedisore. Për më tepër, procesi i prokurimeve do të çojë në përfshirjen e subjekteve me emetim më të ulët të CO<sub>2</sub>.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Prokurimet e gjelbra</b>	Të zbatohen praktika të prokurimeve të gjelbra në të gjitha institucionet e sektorit shëndetësor në Maqedoninë e Veriut, duke e promovuar qëndrueshmërinë mjedisore, duke reduktuar gjurmën e karbonit dhe duke siguruar veprime pro-ekologjike.	Zhvillimi dhe implementimi i politikave për prokurime të gjelbra që i prioritetizojnë blerjen e produkteve dhe shërbimeve pro-mjedisore. Kjo përfshin përcaktimin e kriterëve për prokurime të qëndrueshme, siç është efikasiteti energjetik, më pak paketim dhe përdorim i materialeve jo toksike.	Numri i politikave të implementuara për prokurime të gjelbra; Përqindja e produkteve të prokuruar pro-ekologjike.

### 7.2.12 Ushqyerja dhe Ushqimi

Zbatimi i praktikave të qëndrueshme të ushqyerjes dhe ushqimore në sektorin e shëndetësisë mund të ndikojë me reduktim të konsiderueshëm të emetimeve të GS-ve (kryesisht N<sub>2</sub>O dhe CH<sub>4</sub>), që gjenerohen gjatë prodhimit të ushqimit (p.sh. përdorimi i plehrave, bagëtisë) ose trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve ushqimore (biogjenike). Spitalet dhe objektet e kujdesit shëndetësor janë konsumatorë të mëdhenj të ushqimit dhe mund të paraqiten si shembuj dietik. Nëpërmjet



përvetësimi të praktikave pro-ekologjike të prokurimit të ushqimit, planifikimit dietik, gatimit dhe menaxhimit të mbetjeve, ato mund të ulin sasinë e ushqimit të hedhur, të mbështesin bujqësinë klimatike, të kontribuojnë për shëndetin e njerëzve duke shërbyer më pak mish dhe t'i shkurtojnë shpenzimet.

7.1.4.4 Ushqimi dhe ushqyerja	Meny me konsideratë klimatike dhe përfshirja e këteringut për të gjithë punonjësit në sektorin e shëndetësisë	Promovimi i menyve me konsideratë klimatike dhe reduktim i mbetjeve ushqimore në shërbimet e të ushqyerit dhe ushqimore në të gjitha institucionet në Maqedoninë e Veriut, duke e përforcuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe efikasitetin e resurseve.	Ministria e Shëndetësisë, ISHP, në bashkëpunim me Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra		Drejtëpërsëdrejti: Të gjitha institucionet  Tërthorazi: fermerët lokalë, komuniteti më i gjerë	Zhvillimi dhe promovimi i menyve që priorizojnë ushqimet me bazë bimore, përbërësit e prodhuar në nivel lokal dhe prodhimtarinë sezonale. Reduktimi i përdorimit të produkteve shtazore me impakt të lartë siç është mish i kuq dhe bulmeti, si dhe zëvendësimi i tyre me burime më të qëndrueshme proteinash sikur bishtajoret kokërr, arrorët dhe peshku.	Përqindja e vakteve të ofruara me bazë bimore;  Reduktimi në përdorimin e produkteve shtazore me impakt të lartë;  Rritje në sigurimin e përbërësve të prodhuar në nivel lokal.
	Reduktim i mbetjeve ushqimore	Promovimi i menyve me konsideratë klimatike dhe reduktim i mbetjeve ushqimore në shërbimet e të ushqyerit dhe ushqimore në të gjitha institucionet në Maqedoninë e Veriut, duke e përforcuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe efikasitetin e resurseve.	Ministria e Shëndetësisë, ISHP, në bashkëpunim me Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra		Drejtëpërsëdrejti: Të gjitha institucionet  Tërthorazi: fermerët lokalë, komuniteti më i gjerë	Zbatimi i strategjive për reduktimin e mbetjeve ushqimore në të gjitha fazat e shërbimeve ushqimore, duke përfshirë prokurimin, përgatitjen dhe konsumin. Kjo përfshin zbatimin e auditimeve të rregullta për mbeturinat ushqimore, me optimizimin e madhësive të porcioneve, përmirësimin e magazinimit dhe praktikave të menaxhimit të ushqimit si dhe promovimin e vetëdijesimit për hedhjen e ushqimit në mesin e punonjësve dhe konsumatorëve.	Reduktim i mbetjeve ushqimore të gjeneruara (kg);  Numri i programeve të realizuara për vetëdijesim lidhur me hedhjen e ushqimit;

### 7.2.13 Kimikatet

Ftohësit janë thelbësorë në funksionimin e objekteve shëndetësore, veçanërisht për sistemet e ftohjes, ruajtjen e materialeve medicinale dhe klimatizimin. Megjithatë, ftohësit tradicionalë si hidrofliurokarburet (HFC-të) kanë potencial jashtëzakonisht të lartë të ngrohjes globale (GWP) dhe për këtë arsye rrjedhjet duhet të shmangen dhe të zëvendësohen me gazra me GWP më të ulët. Zbatimi i praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të ftohësve mund t'i reduktojë në nivel drastik këto emetime.

Gazrat anestetikë që përdoren në operacione dhe procedura mjekësore, si oksidi i azotit, sevoflurani, izoflurani dhe desflurani, janë kontribues të mëdhenj në emetimet e gazrave serë. Këto gazra kanë potencial të lartë të ngrohjes globale (GWP) dhe shkarkohen gjatë përdorimit dhe punës me to. Zbatimi i praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të anestesisë mund t'i zvogëlojë këto emetime dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë mjedisore të objekteve shëndetësore.

Gazrat analitikë, që përdoren në procedura të ndryshme diagnostikuese dhe laboratorike, mund të kontribuojnë në emetimet e gazrave serë, veçanërisht metani me një GWP prej 28. Gazrat e tjerë si propani, butani, janë më pak të rëndësishëm. Menaxhimi i qëndrueshëm i këtyre gazrave, duke përfshirë kalimin në alternativa me GWP të ulët dhe optimizimin e përdorimit të tyre, mund të ndikojë me zvogëlim të konsiderueshëm në gjurmën e karbonit të objekteve të kujdesit shëndetësor.

Titulli i projektit	Projekti/Iniciativa/Titulli i masës	Projekti/Iniciativa/Objektivi i masës	Treguesit kryesorë të performansit (KPI-të)
<b>Menaxhimi i qëndrueshëm i ftohësve në objektet shëndetësore</b>	Për reduktimin e emetimit të CO <sub>2</sub> dhe gazrave tjera serë përmes kalimit në alternativa të ftohjes me GWP të ulët, optimizimit të përdorimit të ftohësve dhe përmirësimit të efikasitetit energjetik të sistemeve të ftohjes në objektet e kujdesit shëndetësor.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zëvendësimi i ftohësve me GWP të lartë si HFC-të me alternativa me GWP të ulët si hidrofluroolefinat (HFO-të), amoniaku ose ftohësit me bazë CO<sub>2</sub>.</li> <li>2. Implementimi i sistemeve të avancuara për detektim të rrjedhjeve dhe zbatimi i kontrolleve të rregullta për mirëmbajtje me qëllim që të minimizohen rrjedhjet e ftohësve, që paraqesin burime të mëdha të emetimit.</li> <li>3. Përmirësimi i sistemeve të ftohjes dhe ngrirjes në modele me efikasitet më të madh energjetik që janë kompatible me ftohësit me GWP të ulët.</li> </ol>	Reduktimi i GWP-së në ftohësit që janë në përdorim; Reduktimi i rrjedhjeve të ftohësve.
<b>Menaxhimi i qëndrueshëm i anestetikëve në objektet shëndetësore</b>	Për reduktimin e emetimit të CO <sub>2</sub> dhe gazrave tjera serë përmes kalimit në alternativa të anestetikëve me GWP të ulët, optimizimit të përdorimit të gazrave anestetikë dhe përmirësimit të efikasitetit të sistemeve të aplikimit të anestetikëve në objektet e kujdesit shëndetësor.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mënjanimi gradual i anestetikëve me GWP të lartë siç janë desflurani dhe oksidi i azotit dhe zëvendësimi i tyre me alternativa me GWP më të vogël sikur sevoflurani ose isoflurani.</li> <li>2. Përmirësimi i makinave për anestezi me shkallë më të ulët të rrjedhës së gazit të freskët, që e minimizon vëllimin e gazrave anestetikë që përdoren gjatë procedurave.</li> <li>3. Implementimi i teknologjive me të cilat në mënyrë të sigurt kapen dhe shkatërrohen mbetjet e gazrave anestetikë në vend që vetëm të shkarkohen nëpërmjet ventilimit në atmosferë.</li> </ol>	Reduktimi në GWP-në e anestetikëve të përdorur; Reduktimi në përdorimin e gazrave anestetikë; Rritja në përdorimin e anestetikëve me GWP të ulët.
<b>Menaxhimi i qëndrueshëm i gazrave analitikë në objektet shëndetësore</b>	Për reduktimin e emetimit të CO <sub>2</sub> dhe gazrave tjera serë përmes kalimit në alternativa të gazrave analitikë me GWP të ulët, optimizimit të përdorimit të gazrave dhe përmirësimit të efikasitetit të sistemeve të aplikimit të gazrave në objektet e kujdesit shëndetësor.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mënjanimi gradual i gazrave analitikë me GWP të lartë siç janë disa ftohës dhe tretës që përdoren në kromatografinë e gazit dhe zëvendësimi i tyre me alternativa me GWP më të vogël sikur hidrogjeni, heliumi ose dioksid karboni në formën e tyre të pastër.</li> <li>2. Përmirësimi i sistemeve për aplikim të gazrave për një shkallë më të ulët të rrjedhjes dhe minimizim të vëllimit të mbetjeve. Kjo përfshin instalimin e rregulluesve me efikasitet të lartë, valvulave dhe sistemeve të tubacionit.</li> <li>3. Implementimi i teknologjive me të cilat kapen mbetjet ose sasitë e gazrave të papërdorur gjatë procedurave laboratorike dhe ose bëhet riciklimi i tyre për përdorim të mëtejshëm ose në mënyrë të sigurt i shkatërrojnë ato.</li> </ol>	Reduktimi në GWP-në e gazrave të përdorur analitikë; Reduktimi në përdorimin e gazrave.



## 8 Treguesit e Performancës dhe Monitorimi

Treguesit kryesorë të performancës (KPI-të) janë metrikë thelbësorë që përdoren për të matur efektivitetin dhe progresin e planit të veprimit. Ato ofrojnë të dhëna të matshme që ndihmojnë të bëhet vlerësimi nëse objektivat janë duke u përmbushur si dhe të identifikohen fushat në të cilat ka nevojë për përmirësim.

### 8.1 Treguesit kryesorë të performancës për matjen e progresit drejt objektivave të planit të veprimit

#### **Reduktimi i emetimeve të gazrave serë (GHG):**

**Matja:** Emetimet totale të GHG-ve nga institucionet shëndetësore (në ekuivalente të CO<sub>2</sub>).

**Synimi:** Përqindja e reduktimit të emetimeve të GS-ve në krahasim me një vit bazë.

#### **Efikasiteti Energjetik:**

**Matja:** Konsumi i energjisë për metër katror të hapësirës së objektit shëndetësor (kWh/m<sup>2</sup>).

**Synimi:** Reduktim në përqindjen e konsumit të energjisë.

#### **Përdorimi i energjisë së rinovueshme:**

**Matja:** Përqindja e energjisë që rrjedh nga burimet e rinovueshme.

**Synimi:** Rritje në përqindjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme.

#### **Ruajtja e ujit:**

**Matja:** Konsumi total i ujit për pacient të trajtuar.

**Synimi:** Ulje në përqindjen e përdorimit të ujit.

#### **Menaxhimi i hedhurinave:**

**Matja:** Sasia e hedhurinave medicinale dhe të përgjithshme të krijuara për pacient.

**Synimi:** Reduktimi i përqindjes së hedhurinave të krijuara dhe përqindja e mbetjeve të ricikluara ose të asgjësuara në mënyrë të sigurt.

#### **Infrastrukturë rezistente ndaj klimës:**

**Matja:** Numri i objekteve shëndetësore të përmirësuara ose të ndërtuara me veçori rezistente ndaj klimës.

**Synimi:** Përqindja e objekteve që i përmbushin standardet për rezistencë klimatike.

### **Gatishmëria për shëndetin publik:**

**Matja:** Numri i punonjësve shëndetësorë të trajnuar për qëndrueshmërinë ndaj klimës dhe reagimin në situata emergjence.

**Synimi:** Rritja e përqindjes së personelit të trajnuar.

### **Përfshirja e komunitetit:**

**Matja:** Numri i fushatave të realizuara për vetëdijesimin publik dhe përfshirja e këtyre fushatave.

**Synimi:** Rritje në përqindjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit.

### **Monitorimi i sëmundjeve:**

**Matja:** Numri i epidemive të sëmundjeve të ndjeshme ndaj klimës që janë detektuar dhe për të cilat është reaguar.

**Synimi:** Përqindja e përmirësimit në zbulimin e shpërthimit epidemisë dhe kohën e reagimit.

## 8.2 Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit

Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit (M&E) janë thelbësorë për monitorimin e progresit, vlerësimin e ndikimit të intervenimeve dhe kryerjen e përshtatjeve të nevojshme në planin e veprimit. Këta mekanizma sigurojnë llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm.

### **Mekanizmat e monitorimit:**

#### **Sistemet e mbledhjes së të dhënave:**

**Veprimi:** Implementimi i sistemeve të fuqishme të mbledhjes së të dhënave për të mbledhur të dhëna në kohë reale lidhur me KPI-të nga institucionet e kujdesit shëndetësor dhe burime të tjera përkatëse.

**Veglat:** Krijimi i platformës me bazë digjitale për Ministrinë e Shëndetësisë për mbledhjen e të dhënave lidhur me emetimet e GSve dhe konsumin e energjisë në objektet e kujdesit shëndetësor në nivelin qendror dhe lokal si dhe për analizën dhe raportimin e të dhënave sipas nevojave të institucioneve dhe vendit.

#### **Raportimi i rregullt:**

**Veprimi:** Krijimi i protokolleve të rregullta të raportimit për monitorimin e progresit në baz të KPI-ve.

**Shpeshësia:** Raporte mujore, tremujore dhe vjetore për palët e interesuara dhe publikun.

**Platformat:** Përdorim i paneleve digjitale dhe platformave onlajn për raportim transparent.

#### **Përfshirja e palëve të interesuara:**



**Veprimi:** Angazhimi i palëve të interesuara në procesin e monitorimit për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

**Metoda:** Krijimi i komiteteve këshilldhënëse për palët e interesuara dhe përfshirja e tyre në shqyrtimin e raporteve të progresit dhe dhënien e fidbekut.

### **Mekanizmat e vlerësimit:**

#### **Vlerësimet bazë:**

**Veprimi:** Kryerja e vlerësimeve bazë për përcaktimin e vlerave fillestare për KPI-të para zbatimit të planit të veprimit.

**Qëllimi:** Ofron një pikë referimi për matjen e progresit.

#### **Vlerësimet afatmesme:**

**Veprimi:** Kryerja e vlerësimeve afatmesme për të vlerësuar progresin dhe efektivitetin e planit të veprimit.

**Frekuenca:** Çdo 2-3 vjet.

**Metoda:** Përdorim i anketave, intervistave dhe vizitave në terren për të mbledhur të dhëna cilësore dhe sasiore.

#### **Vlerësimet përfundimtare:**

**Veprimi:** Kryerja e vlerësimeve përfundimtare në fund të ciklit të planit të veprimit për të matur suksesin dhe ndikimin e përgjithshëm.

**Qëllimi:** Identifikimi i leksioneve të nxjerra dhe praktikave më të mira për nismat e ardhshme.

#### **Qarqet e fidbekut:**

**Veprimi:** Krijimi i qarqeve të fidbekut për t'i inkorporuar gjetjet nga vlerësimet në aktivitetet rrjedhëse dhe të ardhshme.

**Metoda:** Përditësimi i rregullt i planeve të veprimit bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe fidbekun e palëve të interesuara.

## **9 Burimet Financiare dhe Mobilizimi**

Planifikimi efektiv financiar dhe shpërndarja e resurseve janë me rëndësi qenësore për zbatimin e suksesshëm të planit të veprimit. Perspektiva e qartë lidhur me kërkesat buxhetore siguron që resurset e duhura të jenë në dispozicion për të mbështetur rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike dhe përpjekjet për dekarbonizimin në sektorin e shëndetësisë.

## 9.1 Përmbledhje e kërkesave buxhetore

### Komponentët kryesorë të kërkesave buxhetore:

#### **Përmirësimet e infrastrukturës:**

**Dizajn rezistent ndaj ndryshimeve klimatike:** Shpenzime që kanë të bëjnë me rinovimin e objekteve ekzistuese të kujdesit shëndetësor dhe ndërtimin e objekteve të reja, rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.

**Integrimi i Energjisë së Rinovueshme:** Shpenzimet për instalimin e paneleve diellore, turbinave të erës dhe sistemeve të tjera të energjisë së rinovueshme.

**Përmirësimet e efikasitetit të energjisë:** Investimet në ndriçimin me efikasitet energjetik, sistemet HVAC dhe izolimin e ndërtesave.

#### **Kostot operative:**

**Trajnimi i stafit:** Buxheti për trajnimin e punonjësve shëndetësorë lidhur me rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike dhe praktikave të qëndrueshme.

**Monitorimi dhe vlerësimi:** Shpenzimet që ndërlidhen me mbledhjen e të dhënave, analizën dhe sistemet e raportimit për monitorim të progresit.

**Fushatat për vetëdijësimin publik:** Financimi për programe arsimore dhe informuese për të ngritur vetëdijen lidhur me rreziqet shëndetësore nga kushtet klimatike.

#### **Shërbimet shëndetësore:**

**Monitorimi i sëmundjeve:** Investime në sisteme të përmirësuara të mbikëqyrjes dhe mekanizma për paralajmërim të hershëm.

**Përgatitja për emergjencë:** Buxheti për planet dhe resurset për reagim ndaj situatave emergjente për të trajtuar rastet emergjente shëndetësore që ndërlidhen me klimën.

#### **Kërkim dhe Zhvillim:**

**Hulumtimet shëndetësore dhe klimatike:** Financim për studime mbi ndikimet shëndetësore të ndryshimeve klimatike dhe efektivitetin e strategjive zbutëse.

**Inovacioni teknologjik:** Investime në zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive të reja për t'i përkrahur praktikave të qëndrueshme të kujdesit shëndetësor.

#### **Përfshirja e komunitetit:**

**Përkrahje për popullatat e cënueshme:** Resurse për intervenimet e synuara për t'i mbrojtur dhe përkrahur komunitetet e cënueshme.

**Ngritja e kapaciteteve:** Shpenzimet që ndërlidhen me programet e ngritjes së kapaciteteve për profesionistët shëndetësorë dhe udhëheqësit e komuniteteve.

## 9.2 Strategjitë për mobilizimin e resurseve financiare duke përfshirë resurset potenciale të financimit

Mobilizimi i resurseve financiare është thelbësor për përkrahjen e zbatimit të planit të veprimit. Kjo përfshin identifikimin dhe sigurimin e financimit nga burime të ndryshme, duke përfshirë fondet ndërkombëtare, buxhetet nacionale dhe investimet private.

### **Fondet Ndërkombëtare Klimatike:**

**Fondi i Gjellbër i Klimës (GCF):** Aplikim për financim nga GCF-ja, i cili i përkrah projektet për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe rritjen e rrezistencës.

**Fondi Global i Mjedisit (GEF):** Shfrytëzim i fondeve të GEF-it për projekte të fokusuar në qëndrueshmërinë mjedisore dhe rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike.

### **Institucionet Financiare të Zhvillimit (DFI):**

**Grupi i Bankës Botërore:** Siguron financim dhe asistencë teknike nga Banka Botërore për projektet shëndetësore në lidhje me kushtet klimatike.

**Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH):** Qasja në fondet e BERZH-it për projektet që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm në kujdesin shëndetësor.

### **Fondet Nacionale:**

**Buxhetet Qeveritare:** Përfaqësim për shpërndarjen e resurseve të buxhetit nacional për t'i përkrahur iniciativat për rezistencën ndaj kushteve klimatike dhe dekarbonizimin në sektorin e shëndetësisë.

**Taksat dhe detyrimet mjedisore:** Shfrytëzim i të ardhurave nga taksat dhe detyrimet mjedisore për financimin e iniciativave të sektorit të shëndetësisë.

### **Investimet e Sektorit Privat:**

**Partneritetet Publiko-Private (PPP):** Formim i partneriteteve me kompani private për bashkëfinansim të projekteve për rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike.

**Programet e Përgjegjesisë Shoqërore Korporative (CSR):** Ndërveprim me korporatat për të financuar projektet në sektorin shëndetësor si pjesë e iniciativave të tyre CSR.

### **Organizatat filantropike:**

**Fondacionet dhe OJQ-të:** Të kërkohen grante dhe donacione nga organizata filantropike që i përkrahin iniciativat për iniciativat klimatike dhe shëndetësore.

### **Mekanizmat novatorë të financimit:**

**Bonot e gjelbra:** Emetimi i bonove të gjelbra për të mbledhur kapital për projekte të qëndrueshme mjedisore në sektorin e shëndetësisë.

**Bonot për Rezistencë Klimatike:** Zhvillimi i bonove për rezistencën klimatike të projektuara posaçërisht për të financuar projekte që e rrisin qëndrueshmërinë e sistemeve të kujdesit shëndetësor.

## 10 Menaxhimi i rrezikut dhe zbutja

Identifikimi i rreziqeve potenciale dhe zhvillimi i strategjive zbutëse është me rëndësi thelbësore për të siguruar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor përballë ndryshimeve klimatike dhe sfidave të tjera.

### 10.1 Identifikimi i rreziqeve potenciale dhe strategjitë e zbutjes së tyre.

#### **Rreziqet e lidhura me klimën:**

**Ngjarjet ekstreme të motit:** Rreziqet i përfshijnë uraganet, përmytjet, valët e të nxehtit dhe stuhitë që mund t'i çrregullojnë shërbimet dhe infrastrukturën e kujdesit shëndetësor.

#### **Strategjitë e zbutjes:**

**Rezistencë e infrastrukturës:** Forcimi i infrastrukturës së kujdesit shëndetësor për t'i bërë ballë motit ekstrem, duke përfshirë barriera kundër përmytjeve, ndërtesa rezistente ndaj stuhive dhe sisteme të përmirësuara të kullimit.

**Përgatitje për emergjencë:** Zhvillimi dhe përditësimi i rregullt i planeve të reagimit ndaj emergjencave, duke siguruar që objektet shëndetësore të jenë të pajisura me energji rezervë dhe furnizimet thelbësore.

**Sistemet e paralajmërimit të hershëm:** Implementimi i sistemeve të avancuara meteorologjike për të gjeneruar paralajmërime të hershme lidhur me ngjarjet ekstreme të motit, duke mundësuar përgatitjen dhe reagimin në kohë.

**Epidemitë e sëmundjeve:**

**Sëmundjet e ndjeshme ndaj klimës:** Rritja e rrezikut nga sëmundjet e transmetueshme nga vektorët (p.sh. malaria, dengoja) dhe sëmundjet e shkaktuara nga uji (p.sh. kolera) për shkak të ndryshimit të kushteve klimatike.

**Strategjitë e zbutjes:**

**Mbikëqyrje e përmirësuar:** Forcimi i sistemeve të monitorimit të sëmundjeve për detektimin dhe reagimin sa më të shpejtë ndaj epidemive.

**Fushatat për Shëndetin Publik:** Zhvillimi i fushatave për shëndetin publik me qëllim që të edukohen komunitetet në lidhje me masat parandaluese dhe simptomat e sëmundjeve të ndjeshme ndaj klimës.

**Kontrolli mbi vektorët:** Zbatimi i masave të kontrollit të vektorëve, siç janë rrjetet e trajtuara me insekticide dhe menaxhimi mjedisor për të reduktuar vendet e shumimit.

**Ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit:**

**Ndërprerje në furnizimet medicinale:** Ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit për shkak të motit ekstrem, konflikteve gjeopolitike ose pandemive mund të çojnë në mungesë të furnizimeve jetësore medicinale.

**Strategjitë e zbutjes:**

**Furnizues të ndryshëm:** Angazhoni furnizues të shumtë për furnizime medicinale thelbësore për të reduktuar varësinë nga një burim i vetëm.

**Magazinimi i rezervave:** Mbani rezerva strategjike të ilaçeve, pajisjeve dhe furnizimeve thelbësore.

**Hartëzimi i zinxhirit të furnizimit:** Zhvilloni harta gjithëpërfshirëse të zinxhirëve të furnizimit për t'i identifikuar dobësitë potenciale dhe rrugët alternative.

**Kufizimet financiare:**

**Kufizimet buxhetore:** Burime të kufizuara financiare për zbatimin e masave për rezistencë ndaj ndryshimeve klimatike dhe dekarbonizim.

**Strategjitë e zbutjes:**

**Diversifikimi i financimit:** Kërkoni burime të ndryshme financimi, duke përfshirë fondet ndërkombëtare klimatike, buxhetet nacionale dhe investimet e sektorit privat.

**Analiza kosto-përfitim:** Kryeni analiza kosto-përfitim për t'u dhënë përparësi intervenimeve që e ofrojnë kthimin më të lartë nga investimi.

**Partneritetet Publiko-Private:** Formoni partneritete me subjekte private për të bashkëfinancuar projektet për rezistencë ndaj ndryshimeve klimatike.

**Sfidat me resurset njerëzore:**

**Mungesat e personelit dhe nevojat për trajnim:** Personel pamjaftueshëm i trajnuar shëndetësor për trajtimin e çështjeve shëndetësore që ndërlidhen me klimën.

**Strategjitë e zbutjes:**

**Programet e trajnimit:** Zbatimi i programeve të vazhdueshme të trajnimit të punonjësve shëndetësorë lidhur me rezistencën ndaj kushteve klimatike dhe reagimin ndaj emergjencave.

**Iniciativa për rekrutim:** Zhvilloni iniciativa rekrutimi për të tërhequr dhe mbajtur profesionistë të kualifikuar të kujdesit shëndetësor.

**Ndryshimi i detyrës:** Përdorni strategji të ndryshimit të detyrave për t'i deleguar përgjegjësitë tek punonjësit shëndetësorë të trajnuar, të cilët nuk janë mjekë, aty ku është e përshtatshme.

## 10.2 Plane për menaxhimin e krizave për adresimin e sfidave të paparashikuara.

Planet e menaxhimit të krizave janë thelbësore për t'i adresuar në mënyrë efektive sfidat e paparashikuara. Këto plane ofrojnë një qasje të strukturuar për menaxhimin e emergjencave, duke siguruar që shërbimet e kujdesit shëndetësor të vazhdojnë të funksionojnë dhe të sigurohet mbarëvajtje e kujdesit për pacientët.

### **Planet e reagimit emergjent**

**Planet e Veprimit:** Zhvilloni plane të detajuara veprimi për lloje të ndryshme emergjencash, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, epidemitë e sëmundjeve dhe ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit.

**Rolet dhe përgjegjësitë:** Qartë përcaktoni rolet dhe përgjegjësitë për të gjithë pjesëtarët e personelit gjatë situatave të emergjencës.

### **Strategjitë e komunikimit:**

**Komunikimi i brendshëm:** Krijoni sisteme të fuqishme të komunikimit të brendshëm për të siguruar që të gjithë pjesëtarët e personelit janë të informuar dhe mund të koordinohen në mënyrë efektive.

**Komunikimi i jashtëm:** Zhvilloni protokolle për komunikimin me pacientët, familjet, publikun dhe autoritetet e jashtme.

**Menaxhimi i resurseve:**

**Shpërndarja e resurseve:** Siguroni disponueshmërinë dhe vendosjen e shpejtë të resurseve thelbësore, duke përfshirë furnizimet medicinale, pajisjet dhe personelin.

**Koordinimi i logjistikës:** Zbatimi i planeve logjistike për të menaxhuar shpërndarjen e resurseve në mënyrë efikase.

**Trajnim dhe stërvitje:**

**Trajnim i rregullt:** Zhvillimi i seancave të rregullta trajnimi për të gjithë personelin lidhur me procedurat e menaxhimit të krizave.

**Stërvitje simulimi:** Organizoni stërvitje simulimi për të testuar dhe përmirësuar gatishmërinë e objekteve të kujdesit shëndetësor.

**Vlerësimi pas krizës:**

**Shqyrtime pas veprimit:** Zbatoni rishikime pas veprimit për të vlerësuar reagimin ndaj një krize dhe për t'i identifikuar leksionet e mësuara.

**Përmirësimi i vazhdueshëm:** Përditësoni planet e menaxhimit të krizave bazuar në gjetjet nga vlerësimet dhe fidbeku nga punonjësit dhe palët e interesuara.

## 11 Referencat:

- OBSH. Ndryshimet klimatike dhe shëndeti. Mund ta gjeni në: [https://www.who.int/health-topics/climate-change#tab=tab\\_1](https://www.who.int/health-topics/climate-change#tab=tab_1).
- OBSH. Shëndeti në ekonominë e gjelbër. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/climate-change-and-health>.
- OBSH. Objektet e kujdesit shëndetësor dhe ndryshimet klimatike. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/health-topics/health-care-facilities>.
- Lancet Numërimi mbrapsht për shëndetin dhe ndryshimet klimatike. Mund ta gjeni në: <https://www.lancetcountdown.org/>.
- Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA). Ndikimet e ndryshimeve klimatike në shëndet. Mund ta gjeni në: <https://www.eea.europa.eu/themes/human/climate-change-impacts-on-human>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Klima dhe Shëndeti. Mund ta gjeni në: <https://www.cdc.gov/climateandhealth/default.htm>.
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Planet Kombëtare të Përshtatjes. Mund ta gjeni në: <https://unfccc.int/topics/adaptation-and-resilience/workstreams/national-adaptation-plans>.
- UNFCCC. Plani Kombëtar i Përshtatjes për Maqedoninë e Veriut. Mund ta gjeni në: [https://unfccc.int/sites/default/files/resource/MKD\\_ES\\_LTS\\_Nov2021.pdf](https://unfccc.int/sites/default/files/resource/MKD_ES_LTS_Nov2021.pdf).
- Komisioni Evropian. Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (NECP). Mund ta gjeni në: [https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/national-energy-climate-plans\\_en](https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/national-energy-climate-plans_en).
- OBSH. Sistemet shëndetësore elastike ndaj klimës. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/activities/building-climate-resilient-health-systems>.
- Menaxhimi i objekteve të kujdesit shëndetësor. Mund ta gjeni në: <https://www.hfmmagazine.com/>.
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA). Efikasiteti i Energjisë për Spitalet. Mund ta gjeni në: <https://www.epa.gov/energy/energy-efficiency-hospitals>.
- OBSH. Infrastrukturë shëndetësore rezistente ndaj klimës. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/publications/i/item/9789241565073>.
- EPA. Efikasiteti i ujit në objektet e kujdesit shëndetësor. Mund ta gjeni në: <https://www.epa.gov/watersense/healthcare>.
- OBSH. Strategjitë e ruajtjes së ujit. Mund ta gjeni në: [https://www.who.int/water\\_sanitation\\_health/publications/water-conservation-strategies](https://www.who.int/water_sanitation_health/publications/water-conservation-strategies).
- GreenBiz. EV-të në kujdesin shëndetësor. Mund ta gjeni në: <https://www.greenbiz.com/topics/health-care>.





- Kujdesi shëndetësor pa dëm Evropë. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve të kujdesit shëndetësor në modelin e ekonomisë qarkore të BE-së. Mund ta gjeni në: <https://europe.noharm.org/media/4483/download?inline=1>.
- OBSH. Menaxhimi i sigurt i mbetjeve nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/publications/i/item/9789241548564>.
- Kujdesi shëndetësor pa dëm Evropë. Reduktimi i Mbetjeve. Mund ta gjeni në: <https://us.noharm.org/waste-management>.
- EPA. Mbetjet mjekësore. Mund ta gjeni në: <https://www.epa.gov/rcra/medical-waste>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Udhëzime për asgjësimin e sigurt të mbetjeve mjekësore. Mund ta gjeni në: <https://www.cdc.gov/infectioncontrol/guidelines/environmental/background/medical-waste.html>.
- Kujdesi shëndetësor pa dëm Evropë. Prokurimi Strategjik në Shëndetësinë Evropiane. Mund ta gjeni në: <https://europe.noharm.org/news/strategic-procurement-european-healthcare>.
- OBSH. Menaxhimi i qëndrueshëm i hedhurinave në shëndetësi. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/activities/promoting-safe-and-sustainable-health-care-waste-management>.
- OBSH. Ndërtimi i sistemeve shëndetësore rezistente ndaj klimës. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/activities/building-climate-resilient-health-systems>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Iniciativa e shteteve dhe qyteteve të gatshme për klimën. Mund ta gjeni në: [https://www.cdc.gov/climateandhealth/climate\\_ready.htm](https://www.cdc.gov/climateandhealth/climate_ready.htm).
- OBSH. Sistemi i paralajmërimit të hershëm, alarmit dhe reagimit. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/publications/i/item/9789241513807>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Angazhimi i Komunitetit në Shëndetin Publik. Mund ta gjeni në: <https://www.cdc.gov/nphpsp/documents/community-engagement.pdf>.
- Karta e Otavës dhe përtej. Fuqizimi i njerëzve për zhvillim të qëndrueshëm. Mund ta gjeni në: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5481890/>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Mbikëqyrja e Shëndetit Publik. Mund ta gjeni në: <https://www.cdc.gov/surveillance/index.html>.
- OBSH. Mbikëqyrja dhe Reagimi i Integruar i Sëmundjeve. Mund ta gjeni në: <https://www.afro.who.int/health-topics/integrated-disease-surveillance-and-response>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Të dhënat dhe statistikën. Mund ta gjeni në: <https://www.cdc.gov/datastatistics/index.html>.
- OBSH. Mbledhja dhe raportimi i të dhënave. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/data/monitoring-and-surveillance>.



- OBSH. Ngritja e Kapaciteteve. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/activities/building-public-health-capacity>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional. Mund ta gjeni në: <https://www.cdc.gov/training/index.html>.
- OBSH. Ndryshimet klimatike dhe shëndeti. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/climate-change-and-health>.
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Përshtatja për komunitetet e cenueshme. Mund ta gjeni në: <https://unfccc.int/topics/adaptation-and-resilience/workstreams/national-adaptation-plans>.
- Instituti Kombëtar i Shkencave të Shëndetit Mjedisor (NIEHS). Ndryshimet klimatike dhe shëndeti i njeriut. Mund ta gjeni në: <https://www.niehs.nih.gov/research/programs/climatechange/index.cfm>.
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Përshtatja për komunitetet e cenueshme. Mund ta gjeni në: <https://unfccc.int/topics/adaptation-and-resilience/workstreams/national-adaptation-plans>.
- OBSH. Hulumtimi i ndryshimeve klimatike dhe shëndetit. Mund ta gjeni në: [https://www.who.int/health-topics/climate-change#tab=tab\\_1](https://www.who.int/health-topics/climate-change#tab=tab_1).
- Instituti Kombëtar i Shkencave të Shëndetit Mjedisor (NIEHS). Ndryshimet klimatike dhe shëndeti i njeriut. Mund ta gjeni në: <https://www.niehs.nih.gov/research/programs/climatechange/index.cfm>.
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Teknologjia dhe Inovacioni i Shëndetit Publik. Mund ta gjeni në: <https://www.cdc.gov/ophss/csels/public-health-technology.html>.
- OBSH. Ndarja e njohurive dhe ngritja e kapaciteteve. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/activities/building-public-health-capacity>.
- Aleanca për Klimën dhe Shëndetin. Bashkëpunimi dhe Avokimi. Mund ta gjeni në: <https://www.caha.org.au/>.
- OBSH. Treguesit për Sistemet Shëndetësore Rezistente ndaj Klimës. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/publications/i/item/9789241565073>.
- UNICEF. Udhëzues për Monitorimin dhe Vlerësimin. Mund ta gjeni në: [https://b2315f08-09cf-4a7a-b224-5b9df6403e51.usrfiles.com/ugd/b2315f\\_3ff09db365cc4511b43e22d7df232a12.pdf](https://b2315f08-09cf-4a7a-b224-5b9df6403e51.usrfiles.com/ugd/b2315f_3ff09db365cc4511b43e22d7df232a12.pdf).
- Fondi Global i Mjedisit (GEF). Mund ta gjeni në: [https://www.thegef.org/sites/default/files/council-meeting-documents/EN\\_GEF.ME\\_C56\\_02\\_Rev01\\_GEF\\_Evaluation\\_Policy\\_June\\_2019\\_0.pdf](https://www.thegef.org/sites/default/files/council-meeting-documents/EN_GEF.ME_C56_02_Rev01_GEF_Evaluation_Policy_June_2019_0.pdf).
- Fondi i Gjelbër i Klimës (GCF). Mund ta gjeni në: <https://www.greenclimate.fund>.
- Fondi Global i Mjedisit (GEF). Mund ta gjeni në: <https://www.thegef.org/>.



- Grupi i Bankës Botërore. Ndryshimet Klimatike. Mund ta gjeni në: <https://www.worldbank.org/en/topic/climatechange>.
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). EBRD Green. Mund ta gjeni në: <https://www.ebrd.com/what-we-do/ebd-green.html#:~:~=The%20EBRD%20is%20a%20klima,of%20our%20six%20transition%20qualities>.
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Buxhetimi për Ndryshimet Klimatike. Mund ta gjeni në: <https://www.undp.org/publications/budgeting-climate-change-guidance-note-governments-integrate-climate-change-budgeting>.
- OBSH. Gatishmëria për Emergjencë. Mund ta gjeni në: <https://www.who.int/emergencies/preparedness>.
- Agjencia Federale e Menaxhimit të Emergjencave (FEMA). Bazat e klimës për menaxherët e urgjencës. Mund ta gjeni në: [https://www.fema.gov/sites/default/files/documents/fema\\_climate-essentials\\_072023.pdf](https://www.fema.gov/sites/default/files/documents/fema_climate-essentials_072023.pdf).

